

Tiranë __.04.2026

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

Erion Veliaj, i biri i Luan dhe i Shqiponjë, i datëlindjes
17.12.1979, lindur e banues në Tiranë

I.E.V.P. – DURRËS

Lagjja nr. 17, ish-këneta, Durrës.

Përfaqësuar nga Av. Plarent Ndreca, sipas tagrave të
përfaqësimit të prokurës së përgjithshme të datës 17.03.2026,
bashkëlidhur kësaj kërkesë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E POSAÇME

KUNDËR KORRUPSIONIT

DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Rruga "Jordan Misja", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri

OBJEKTI:

1. Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën i vendimit nr.29, datë 9.02.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (vendim i gjyqtarit te seancës paraprake znj. Etleva Deda).
2. Pavlefshmëria e të gjitha seancave të zhvilluara në lidhje me procedimin penal nr. 27/2024 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar pas datës së dhënies së vendimit

nr.29, datë 9.02.2026 të gjyqtarit të seancës paraprake
znj. Etleva Deda.

3. Konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën të paragrafit të parë, gërma “a”, të nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale.
4. Konstatimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr. 95, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
5. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 4, 31, 42 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
3. Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.

DREJTUAR:

GJYKATËS KUSHTETUESE

TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 26

Tiranë, Shqipëri

————— ◆ —————

Të nderuar anëtarë të Gjykatës,

In processus, forma est substantia

————— ◆ —————

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Kërkuesi z. Erion Veliaj nga viti 2015 e në vijim ushtron funksionin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, i zgjedhur për tre mandate radhazi. Prokuroria e Posaçme Kundër

Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, duke marrë shkas nga një kallëzim anonim, në datën 08.02.2024 ka regjistruar procedimin penal Nr.27/2024, aktet e të cilit bëjnë fjalë për veprën penale të "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, pa autor.

2. Në korrik 2023 pranë Prokurorisë së Posaçme është protokolluar një kallëzim penal nga një shtetas anonim, i vetëquajtur Nesti Angoni, për të cilin nuk ka asnjë gjurmë në regjistrin e gjendjes civile. Kallëzimi anonim nuk përmban asnjë provë bashkalidhur, përmban vetëm sa më poshtë vijon:

Të nderuar jam një qytetar i Tiranës që dua tu vej në dijeni të disa fakteve që i shoh si kompromentuese për kryetarin e bashkisë Tiranë, zotin Erion Veliaj dhe marrëdhëniet e tij me pronarin e shoqërisë Agikons, Genti Sula. Kur Erion Veliaj u bë ministër morri një banesë në bllokun Kodra e Diellit në pronësi të Genti Sula dhe gruaja e tij u bë zëvendësministre tek Ministria Punës (kjo banesë më vonë është shtuar me një kat dhe me ashensor të vecantë). Që nga ajo kohë marrëdhënia e të dyve është e pandarë.... Shoqëria Agikons, me pronar Gent Sula ka "fituar" një pafundësi ndërtime në Tiranë, si shkollën tek ish sheshi Shqiponja, parkun Rinia, Operan, Maternitetin, spitalin e ri, godina te Universiteti Bujqësisë dhe tani flitet edhe për Teatrin Kombëtar. Nuk mund të them se si është fituar kontrata për këto ndërtime... Sot Erion Veliaj ka në pronësi 3 vila në fshatin rezidencial në Qerret Kavajë të ndërtuar nga shoqëria Agikons e Genti Sula. Nga këto një vilë e posedon i vëllai Erion Veliaj, tjetrën Erion Veliaj të dyja të rikonstruara dhe të tretën e ka rrafshuar. Këto vila kanë një vlerë tregu plus rikonstruksionin që shkon rreth 500 mijë euro. Vila e tretë tashmë e rrafshuar për të krijuar më shumë hapësirë, pra hedh në plehra 500 mijë euro për hic. Për prishjen e saj kanë punuar makineritë e Ujësjiellësi Kavajë. A ka një leje për prishjen apo ndonjë faturë të punimeve? Të gjitha këto ngrenë pyetjen ku i gjeti paratë Erioni dhe a ka dokumenta të blerjeve, pagesave bankare, apo pronësia e tyre ka mbetur formalisht të ndërtuesi. Këto janë pak probleme që mendoj se tregojnë shumë. Uroj që të kem dhënë një informacion të vlefshëm në luftën kundër korrupsionit.

3. Plot 7 muaj i janë dashur Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së për verifikimin e një kallëzimi të nënshkruar nga shtetasi anonim Nesti Angoni, gjithsej 1 fletë, ndërkohë që brenda

15 ditëve prokurori duhet të kishte konstatuar ekzistencën e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e një procedimi penal, apo në të kundërt, të kishte regjistruar procedim penal. Për më tepër që përmbajtja e këtij kallëzimi anonim lidhet me fakte të njohura për publikun (*si psh emërimi i z. Veliaj si Ministër i Punës dhe znj. Sula si zv. Ministre e Punës*) që nuk kishin pse të merrnin shumë muaj kohë për t'u verifikuar nga një strukturë e specializuar si Prokuroria e Posaçme.

4. Në datën 8 Shkurt 2024 Prokuroria e Posaçme ka administruar informacionin për referimin e veprës penale nga BKH-ja dhe po atë ditë, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal Nr.27 të vitit 2024, pa autor konkret, edhe pse i hetuar *de facto* prej asaj kohe ka qënë Kryetari i Bashkisë Tiranë. Ky referim policor ka patur synim verifikimin e rrethanave që paraqiste kallëzuesi anonim në Korrik 2023, pa cituar asnjë të dhënë që krijon dyshim për akt korruptiv, aq më pak për vepra të tjera si pastrimi i produkteve të veprës penale etj.

5. Me vendimin e datës 27.12.2024 organi i akuzës ka vlerësuar të urdhërojë shënimin në regjistrin për njoftimin e veprave penale nenet 245, 287/2 e 257/a/2 të Kodit Penal, edhe këto vepra objekt hetimi nuk i atribuohen deri në këtë datë ndonjë personi konkret. Njëkohësisht me paraqitjen e kërkesës për caktim mase sigurimi sipas nenit 244 të K.Pr.Penale, Prokuroria e Posaçme ka urdhëruar shënimin në regjistër për njoftimin e veprave penale të emrit të personit nën hetim Erion Veliaj, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 260-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.

6. Me përfundimin e hetimeve paraprake, në datë 10.09.2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 27 të vitit 2024 të saj, ndaj të pandehurve Erion Veliaj etj., (përcjellë me shkresën nr. 31207 Prot./O.D., datë 10.09.2025, me lëndë: “Dërgohet kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq”, të Drejtuesit të Prokurorisë Altin Dumani).

7. Kjo çështje u regjistrua në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar po në datë 10.09.2025, me numër 141 të Regjistrimit Themeltar. Me vendimin nr. nr.29, datë 9.02.2026, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtarja e seancës paraprake) vendosi dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 27. të vitit 2024 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kundër të pandehurve, ndër të cilët edhe z. Veliaj.

8. Duke e konsideruar këtë vendim të gjyqtarit të seancës paraprake, në kundërshtim me Kushtetutën, kërkojmë shfuqizimin e këtij vendimi, me arsyetimin vijues.

II. LEGJITIMIMI I KËRKUESIT

9. Në lidhje me legjitimimin e kërkuesit për të paraqitur këtë kërkesë para Gjykatës Kushtetuese, dhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kësaj kërkesë, sqarohet se kërkuesi legjitimohet në paraqitjen e kësaj kërkesë si subjekt i parashikuar nga nenet 131, gërma “f”; 134, gërma “g” të Kushtetutës për arsye të mëposhtme:

10. **Së pari:** Bazuar në nenin 134/i të Kushtetutës dhe nenin 49, paragrafi 3, gërma “e” e Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë në pozicionin e subjektit ndaj të cilit ka dalë vendimi objekt shqyrtimi i gjyqtarit të seancës paraprake znj. Etleva Deda, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe pretendon se ky vendime cënon të drejtat kushtetuese të tij.

11. **Së dyti:** Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sepse e ka paraqitur ankimin brenda afatit 4 mujor të parashikuar në nenin 71/a, paragrafi i parë, gërma “b” e Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

12. **Së treti:** Gjithashtu pasojat e ardhura nga vendimi objekt shqyrtimi kanë pamundësuar në mënyrë reale dhe të drejtpërdrejtë të drejtat kushtetuese të kërkuesit. Shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtat e shkelura të kërkuesit. Si rrjedhojë, kërkuesi përmbush edhe kërkesat e nenit 71/a, paragrafi i parë, gërma “c” dhe “ç” e Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, sipas të cilit:

Neni 71/a

Kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual

1. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

c) pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin;

ç) shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.

13. **Së katërti:** Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*. Neni 332/dh i KPrP me titull “Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake”, parashikon se nëse gjykata e seancës paraprake vendos dërgimin e çështjes në gjyq, vendimi depozitohet në sekretari brenda 10 ditëve nga shpallja e tij. Palët kanë të drejtë të marrin kopje të tij. Neni 332/e, me titull “Elementet e vendimit”, parashikon se vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq përmban: a) gjenealitetet e

të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale që vlejnë për identifikimin e tij, si dhe gjenealitetet e palëve private dhe të mbrojtësve të tyre; b) gjenealitetet e viktimës, në rast se rezultojnë të identifikuar; c) parashtrimin e faktit penal dhe rrethanave të tij, duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit; ç) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen; d) dispozitivin, duke treguar dhe gjykatën kompetente për gjykimin e çështjes; dh) përcaktimin e adresës së të pandehurit, viktimës ose trashëgimtarët e tij dhe palëve të tjera në proces, për efekt të njoftimeve të mëtejshme; e) datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit dhe të sekretarit të seancës gjyqësore. Vendimi është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungojnë ose janë të pamjaftueshme kërkesat e parashikuara në shkronjën “c”, pika 1, të këtij neni. Neni 332/f i KPrP me titull “Depozitimi i fashikullit të gjykimit”, parashikon se vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq, së bashku me fashikullin e gjykimit dhe me aktet e masave të sigurimit, depozitohen pa vonesë në sekretarinë e gjykatës kompetente dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë. Neni 332/gj, me titull “Ankimi”, parashikon se kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankimi. Në vijim, në mënyrë eksplicite, përmbajtja e dispozitave të përmbledhura më sipër:

Neni 332/dh

Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake

1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos:

- a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës;*
- b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimin të fajësisë dhe caktimin e dënimit;*
- c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë.
Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit;*
- ç) pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi; d) deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj.*

2. Vendimi depozitohet në sekretari brenda 10 ditëve nga shpallja e tij. Palët kanë të drejtë të marrin kopje të tij.

3. Procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj.

Neni 332/e

Elementet e vendimit

1. Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq përmban:

a) gjenealitetet e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale që vlejné për identifikimin e tij, si dhe gjenealitetet e palëve private dhe të mbrojtësve të tyre;

b) gjenealitetet e viktimës, në rast se rezulton e identifikuar;

c) parashtrimin e faktit penal dhe rrethanave të tij, duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit;

ç) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen;

d) dispozitivin, duke treguar dhe gjykatën kompetente për gjykimin e çështjes;

dh) përcaktimin e adresës së të pandehurit, viktimës ose trashëgimtarët e tij dhe palëve të tjera në proces, për efekt të njoftimeve të mëtejshme;

e) datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit dhe të sekretarit të seancës gjyqësore.

2. Vendimi është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungojnë ose janë të pamjaftueshme kërkesat e parashikuara në shkronjën “c”, pika 1, të këtij neni.

Neni 332/f

Depozitimi i fashikullit të gjykimit

Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq, së bashku me fashikullin e gjykimit dhe me aktet e masave të sigurimit, depozitohen pa vonesë në sekretarinë e gjykatës kompetente dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë.

Neni 332/gj

Ankimi

1. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankimi.

2. Kundër vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes prokurori, i pandehuri dhe viktimia ose trashëgimtarët e saj mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.

14. Lidhur me shterimin e mjeteve juridike si kusht për t'u legjitimuar ne paraqitjen e kërkesës individuale ne Gjykatën Kushtetuese, kjo Gjykatë ka një jurisprudencë të pasur. Detyrimi për shterimin e mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe

134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, është trajtuar nga Gjykata si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur procesin gjyqësor (*vendimet nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të GJK*), ashtu edhe të atyre të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të GJK*).

15. Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në zbërthim të këtij parashikimi, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*vendimet nr. 53, datë 22.12.2011; nr. 28, datë 23.06.2011; nr. 27, datë 20.06.2007 të GJK*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*vendimet nr. 60, datë 21.09.2015; nr. 17, datë 16.05.2011; nr. 1, datë 25.01.2010; nr. 1, datë 19.01.2009 të GJK*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*vendimet nr.17, datë 16.05.2011; nr.1, datë 25.01.2010; nr.17, datë 18.07.2005 të GJK*).

16. Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë **të përshtatshme, të disponueshme DHE TË FRYTSHME** për një çështje konkrete (*vendimi nr. 27, datë 20.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. (*vendimi nr. 1, datë 19.01.2009 i Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, bën fjalë për **shterimin e atyre mjeteve juridike QË JANË TË AFTA PËR TË RIVENDOSUR TË DREJTËN QË PRETENDOHET SE ËSHTË SHKELUR** (*vendimet nr. 6, datë 16.02.2023*

të Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK; vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të GJK).

17. Gjykata ka theksuar se neni 131/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar që do të thotë se individit duhet t'i ketë shterur mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Juridiksioni kushtetues, për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt, bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shterur mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjete ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. (vendimi nr.15, datë 18.04.2007 të GJK).

18. Gjykata vlerëson se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Dhunimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte. Duke qenë se kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit për “masën e arrestit në burg” dhe ankohet ndaj një vendimi të Gjykatës së Lartë, karakteri i këtij vendimi të ndërmjetëm e kërkon, si përjashtim, që ai të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 30/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

19. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), lidhur me zbatimin e nenit 6 të Konventës, për vendimet e ndërmjetme është shprehur: “Procedurat paraprake, të tilla si ato që kanë të bëjnë me vendosjen e një mase të ndërmjetme, si p.sh. një urdhërim, normalisht nuk konsiderohen të jenë vendimtare për të drejtat dhe detyrimet civile dhe, si pasojë, normalisht nuk bien nën mbrojtjen e nenit 6 të Konventës. (Wiot kundër Francës, vendim i datës 15 mars 2001; APIS a.s. kundër Sllovakisë, vendim i datës 13 janar 2002; Libert kundër Belgjikës, vendim i datës 8 korrik 2004). Megjithatë, në disa raste, GJEDNJ-ja ka zbatuar nenin 6 të Konventës për vendimet e ndërmjetme, sepse ato kanë qenë përfundimtare për sa i përket të drejtave civile të aplikuesit. (Aerts kundër Belgjikës vendim i datës 30 korrik 1998). Për më tepër, është vlerësuar nga GJEDNJ-ja se një përjashtim duhet bërë nga parimi, se neni 6 i

Konventës nuk aplikohet për vendime të ndërmjetme, **KUR NATYRA E VENDIMIT TË NDËRMJETËM E KËRKON KËTË PËRJASHTIM.** (*Markass Car Hire Ltd kundër Qipros, vendim i datës 23 Tetor 2001, Micallef vs. Malta, vendim i datës 15 tetor 2009*)

20. Përrjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Gjykata ka vlerësuar në një rast se shkelja e pretenduar lidhet pikërisht me faktin se, edhe pse gjykimi për objektin e padisë është ende në shqyrtim në gjykatën e apelit, për rrjedhojë vendimi i kundërshtuar nuk konsiderohet përfundimtar në atë drejtim, është natyra e pretendimit të ngritur, përkatësisht shkelja e parimit *res judicata*, që justifikon shqyrtimin e kësaj çështjeje në nivel kushtetues. Për sa kohë që **NJË SHKELJE E TILLË DHE PASOJAT E SAJ NUK MUND TË RIPAROHESHIN MË** gjatë rigjykimit të çështjes, pra **NË PROCESIN GJYQËSOR QË ISHTE DUKE U ZHVILLUAR NË JURIDIKSIONIN E ZAKONSHËM**, Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk kishte mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, ndaj e legjitimoi atë për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë (shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023, parag. 16, të GJK).

21. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, i cili përcakton natyrën “përfundimtare” të gjykimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese ka ritheksuar se, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendimet e ndërmjetme që jepen gjatë një procesi gjyqësor. Megjithatë, ky përjashtim zbatohet vetëm kur plotësohen disa kritere që lidhen **ME PASOJAT E DREJTPËRDREJTA NDAJ SË DREJTËS SË INDIVIDIT.** Në këtë kuptim, vendimi i ndërmjetëm duhet që të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar. Po ashtu, ky lloj vendimi i ndërmjetëm duhet **TË KETË NJË MASË AUTONOMIE NGA PROCESI I THEMELIT, NË KUPTIMIN QË PAVARËSISHT SE SHQYRTIMI GJYQËSOR I MOSMARRËVESHJES SË THEMELIT VAZHDON, VENDIMI PËRFUNDIMTAR QË DO TË JEPET NË THEMEL NUK ËSHTË I AFTË TË NDRYSHOJË VENDIMIN E NDËRMJETËM DHE AS TË RIPAROJË NË MASËN E DUHUR EFEKTET QË AI KA SJELLË.** Po aq rëndësi ka edhe fakti që **SHKELJA E PRETENDUAR TË JETË PASOJË E DREJTPËRDREJTË E VENDIMIT TË NDËRMJETËM TË KUNDËRSHTUAR, PRA KËRKUESI DUHET TË PROVOJË SE**

ËSHTË VIKTIMË E SHKELJES TË SË DREJTËS KUSHTETUESE. (shih vendimin nr. 14 datë 11.03.2021 i Gjykatës Kushtetuese)

22. Ligjvënësi ka parashikuar që kalimi nga faza e hetimit paraprak në fazën e gjykimit në themel bëhet vetëm përmes një akti formal, vendimit të shkruar të gjyqtarit të seancës paraprake, të arsyetuar dhe të depozituar në sekretarinë e gjykatës. Pa këtë akt, procesi nuk kalon nga një fazë në tjetrën në mënyrën e parashikuar nga ligji dhe i pandehuri nuk hyn në gjykim mbi baza procedurale të ligjshme. I pandehuri duhet të dijë jo vetëm tekstin e akuzës së prokurorisë, por edhe arsyetimin e gjykatës së seancës paraprake mbi mjaftueshmërinë e provave për ta çuar çështjen në gjykim. Kjo është një e drejtë e dallueshme nga e drejta për t'u njohur me akuzën, sepse përfshin kontrollin gjyqësor mbi ligjshmërinë e procedimit dhe mjaftueshmërinë e tij për t'u dërguar për gjykim. Seanca paraprake është krijuar pikërisht për të shmangur kalimin e çështjeve në gjykim pa filtër gjyqësor, pa prova të mjaftueshme ose pa respektuar kërkesat e ligjit.

23. Fakti që neni 332/gj/1 i Kodit të Procedurës Penale përjashton në mënyrë të shprehur çdo mjet ankimi kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, prodhon një pasojë të drejtpërdrejtë: asnjë gjykatë e juridiksionit të zakonshëm nuk ka kompetencë funksionale për të konstatuar, rishikuar ose korigjuar paligjshmëritë dhe antikushtetutshmëritë e këtij vendimi. Ky përjashtim procedural ka karakter absolut dhe nuk lë asnjë mjet juridik të zakonshëm të disponueshëm për të adresuar pretendimet që lidhen me vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake.

24. Gjykata e themelit nuk ka kompetencë të rishqyrtojë vendimin e seancës paraprake, sepse ligji e kufizon funksionin e saj vetëm në shqyrtimin e akuzës dhe provave në themel. Ajo nuk mund të deklarojë të shfuqizojë vendimin e seancës paraprake. Kjo gjykatë i nënshtrohet vendimit të dërgimit në gjyq si një fakt procedural i konsumuar, të cilin ajo nuk ka kompetencë ta rikthejë, ndryshojë apo korigjojë. Kjo do të thotë se, edhe nëse i pandehuri kundërshton në gjykimin në shkallë të parë ose në apel, vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, gjykatat e zakonshme nuk kanë kompetencë ligjore për të marrë në shqyrtim vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjykim. As gjykata e apelit nuk ka kompetencë ligjore ta marrë në shqyrtimin ankimin ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake. Gjithashtu, asnjë vendim i mëvonshëm i themelit të gjykatës së shkallës së parë, ose apelit, qoftë edhe pafajësia, nuk e kompenson faktin që gjykimi është zhvilluar në çanim të të drejtave themelore kushtetuese, pjesë e të drejtës për proces të rregullt ligjor, siç janë të drejtat që kërkuesi kundërshton përmes kërkesës kushtetuese objekt gjykimi, më konkretisht: e drejta për t'u njohur me aktet e procedimit dhe për të pasur një mbrojtje efektive; e drejta për

t'u gjykuar nga gjykatë e pavarur; cënimi i parimit të prezumimit të pafajësisë; si dhe parimimi i sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, në të cilin përfshihet edhe e drejta për t'u hetuar nga një prokuror i emëruar në përputhje me kriteret ligjore.

E drejta për proces të rregullt ligjor duhet të respektohet në çdo fazë të procedimit, veçanërisht në fazën paraprake, e cila ka funksion filtrues dhe garantues.

25. Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, Shteteve Kontraktuese u njihet njëfarë diskrecioni (ose një “hapësirë vlerësimi”) sa i përket mënyrës se si ato ofrojnë mjetin juridik të nevojshëm dhe përputhen me detyrimet e tyre sipas Konventës në bazë të nenit 13 (*Kaya kundër Turqisë*, 1998, § 106). As neni 13 dhe as Konventa në tërësi nuk parashikojnë për Shtetet Kontraktuese një mënyrë të caktuar për të siguruar, në kuadrin e ligjit të tyre të brendshëm, zbatimin efektiv të ndonjë prej dispozitave të Konventës (*Silver dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1983, § 113; *Council of Civil Service Unions dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Komisionit, 1987). Por natyra e së drejtës në fjalë ka pasoja për llojin e mjetit juridik që Shteti është i detyruar të ofrojë sipas nenit 13 (*Budayeva dhe të Tjerë kundër Rusisë*, 2008, § 191). Nëse autoriteti ose gjykata përkatëse e riformulon ankesën ose **dështon të marrë në konsideratë një element thelbësor të shkeljes së pretenduar të Konventës, mjeti juridik është i pamjaftueshëm** (*Glas Nadezhda EOOD dhe Elenkov kundër Bullgarisë*, 2007, § 69). Termi “efektiv” nënkupton që mjeti juridik duhet të jetë **i mjaftueshëm dhe i aksesueshëm**, duke përmbushur detyrimin për **shpejtësi** (*Paulino Tomás kundër Portugalisë* (vendim), 2003; *Çelik dhe Ìmret kundër Turqisë*, 2004, § 59). Mjeti juridik duhet të mundësojë paraqitjen e një ankese për shkeljen e pretenduar të Konventës. Një mjet juridik i brendshëm duhet të paraqesë **garancitë minimale të shpejtësisë** (*Kadiķis kundër Letonisë* (nr. 2), 2006, § 62). Një mjet juridik që **nuk jep rezultat në kohën e duhur është i papërshtatshëm dhe joefektiv** (*Pine Valley Developments Ltd dhe të Tjerë kundër Irlandës*, 1991, § 47; *Payet kundër Francës*, 2011, §§ 131-134).

26. Në kundërshtim me sa më sipër, në rastin konkret, bazuar në parashikimet e KPrP, gjykata e apelit, si gjykata që, mbi bazën e ankimit, kontrollon ligjshmërinë e vendimmarrjes së themelit të gjykatës së shkallës së parë, ushtron kompetencë vetëm mbi vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë. Nëse çështja ngrihet përmes ankimit në apel, kjo gjykatë shqyrton vetëm ligjshmërinë e vendimit përfundimtar dhe pretendimet e lidhura me gjykimin në themel. Ajo nuk mund të shqyrtojë ligjshmërinë e vendimit të seancës paraprake, sepse nuk ka objekt juridik për të shqyrtuar: vendimi nuk është i ankimeshëm dhe nuk ekziston mekanizëm normativ që t'i japë apelit kompetencë për të trajtuar parregullsi të fazës paraprake. Sipas Kodit të Procedurës Penale, lidhur me këtë fazë të procesit, pra seancën paraprake, asnjë

paligjshmëri nuk mund të konstatohet nga gjykatat e zakonshme, ndryshe nga çdo fazë tjetër e procesit. Gjithashtu, edhe Gjykata e Lartë e cila ushtron kontroll kufizuar të ligjshmërisë, nuk mund të marrë në shqyrtim pretendime që lidhen me shkeljet e seancës paraprake, sepse rekursi nuk parashikohet për këtë vendimmarrje dhe nuk mund të shtrihet përtej kufijve të vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë nuk mund të rishqyrtojë një vendim që me ligj është i paankimueshëm.

27. Neni 332/gj, gërma “b” parashikon se: “Kundër vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes prokurori, i pandehuri dhe viktima ose trashëgimtarët e saj mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.”. Gjithashtu edhe në rastin kur shqyrtohet nga gjykata e seancës paraprake kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes, cilado të jetë vendimmarrja e kësaj gjykate lidhur me këtë kërkesë të prokurorit, në bazë të nenit 329/b, prg. 6, lejohet ankim në gjykatën e apelit, më konkretisht: *“Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit. Zbatohen për aq sa janë të pajtueshme rregullat e përcaktuara në nenin 329 të këtij Kodi.”*

28. Nga sa më sipër, neni 332/gj të Kodit të Procedurës Penale parashikon ndalimin absolut të ankimit ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq, ndërkohë që, në të njëjtën fazë procedurale, legjislacioni lejon ankim për çdo vendim që lidhet me pushimin e akuzës ose të çështjes, si ndaj vendimit të gjykatës që pranon kërkesën për pushimin e akuzës ose çështjes, edhe ndaj vendimeve të tjera që mund të japë gjyqtari i seancës paraprake në këtë fazë: vendimi për kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve; si dhe vendimin për kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes. Konkretisht, në bazë të kësaj dispozite dhe nenit 329/b, paragrafi 6, të Kodit të Procedurës Penale, çdo vendimmarrje e gjyqtarit të seancës paraprake mbi kërkesën e prokurorit për pushim, pavarësisht nëse ajo pranohet apo refuzohet, i nënshtrohet kontrollit të gjykatës së apelit. Nga ky regjim normativ rezulton se ligjvënësi ka ndërtuar një sistem të diferencuar të ankimit, ku kontrolli gjyqësor është i garantuar për vendimet që lidhen me pushimin e procedimit penal, ndërsa përjashtohet në mënyrë absolute për vendimin që dërgon çështjen në gjyq. Ky trajtim i ndryshëm nuk mbështetet në asnjë kriter objektiv dhe të arsyeshëm, përkundrazi krijon një pabarazi të thellë në strukturën e procesit penal.

29. Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq nuk është një akt formal apo thjesht organizativ, por përbën një akt gjyqësor me ndikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm mbi pozitën procedurale të të pandehurit. Përmes këtij vendimi, gjyqtari i seancës paraprake vlerëson ekzistencën e provave të mjaftueshme për mbështetjen e akuzës dhe përcakton

objektin e gjykimit në themel. Si i tillë, ky vendim konsolidon bazën mbi të cilën do të zhvillohet gjykimi dhe ekspozon të pandehurin ndaj një procesi penal të plotë, me të gjitha pasojat që rrjedhin prej tij. Në këtë kuptim, vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq përfaqëson ndërhyrjen më të rëndë në pozitën procedurale të të pandehurit në këtë fazë të procesit. Megjithatë, pikërisht ky vendim përjashtohet në mënyrë absolute nga çdo mundësi kontrolli gjyqësor, ndërkohë që vendimet lidhur me pushimin e çështjes, i nënshtrohen kontrollit të plotë të gjykatës së apelit.

30. Parimi themelor i shtetit të së drejtës kërkon që sa më i madh të jetë intensiteti i ndërhyrjes në të drejtat e individit, aq më i fortë duhet të jetë kontrolli gjyqësor mbi atë ndërhyrje. Në rastin konkret ndodh e kundërta: vendimi me ndikimin më të madh mbi të drejtat e të pandehurit është i pakontrollueshëm, madje as bashkë me vendimin e themelit, sepse neni objekt shqyrtimi ka ndaluar çdo mundësi ankimi për këtë vendim, duke mos lejuar ankim as bashkë me vendimin e themelit. Një rregullim i tillë është në thelb arbitrar. Për më tepër, ky regjim cenon parimin e barazisë së armëve, si element thelbësor i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke garantuar kontroll gjyqësor për vendimet që prekin interesat e akuzës (pushimi i çështjes), por duke e përjashtuar këtë kontroll për vendimet që rëndojnë drejtpërdrejt pozitën e të pandehurit (dërgimi në gjyq), ligjvënësi ka krijuar një disbalancë strukturore në raportin ndërmjet palëve.

31. Pra në thelb, neni 332/gj e ka mbyllur tërësisht rrethin e mjeteve procedurale brenda sistemit të zakonshëm: asnjë gjykatë nuk ka kompetencë të ndërhyjë, jo sepse parregullsia nuk ekziston, por sepse ligji nuk i jep asnjë organi gjyqësor të zakonshëm mjetin për ta konstatuar dhe korrigjuar atë. Kjo e çon çështjen në një situatë ku ligjshmëria e vendimit të seancës paraprake mbetet jashtë çdo kontrolli gjyqësor të zakonshëm. Kjo strukturë normative e bën **vendimin e seancës paraprake një akt procedural *de facto* të imunizuar nga çdo kontroll i juridiksionit të zakonshëm, duke e shndërruar në një akt që, edhe kur është në kundërshtim flagrant me KPrP ose me Kushtetutën, nuk mund të shfuqizohet më.** Pikërisht për këtë arsye, kriteri i “shterimit të mjeteve juridike” është plotësuar në kuptimin e nenit 131/f të Kushtetutës, sepse mjetet mungojnë në mënyrë formale dhe si rrjedhojë janë të pazbatueshme dhe jofunksionale edhe në aspektin praktik e substancial.

32. Një element tjetër i rëndësishëm, që e forcon pamundësinë e plotë të korrigjimit të parregullsive të vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, është fakti se Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon as mundësinë e ngritjes së këtyre shkeljeve “bashkë me ankimin ndaj vendimit përfundimtar”. Kjo është thelbësore, sepse në raste të tjera, edhe kur një vendim i

ndërmjetëm nuk është i ankimeshëm në mënyrë të menjëhershme/veçantë, legjislatori u njeh palëve të drejtën të sfidojnë shkeljet e tij në momentin kur ata ankimojnë vendimin final. Por kjo logjikë nuk ekziston në KPrP për fazën e seancës paraprake. Neni 332/gj KPrP vendos një ndalim kategorik: *“Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankim.”*. Pikërisht sepse ndalimi është absolut dhe pa përjashtime, nuk ka asnjë mekanizëm që t’i lejojë palët të ngrenë më pas, në apel ose në rekurs, parregullsitë ose antikushtetutshmëritë e kësaj faze.

33. Gjithashtu, siç kemi evidentuar më sipër, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, një vendim i ndërmjetëm konsiderohet i ankimeshëm në kontrollin kushtetues nëse ai ka efekte të pavarura dhe të pakthyeshme ndaj një të drejte kushtetuese. Vendimi për dërgimin e çështjes në gjykim është një vendim i këtij lloji. Pasi shpallet, ai i ekspozon menjëherë të pandehurit ndaj një procesi penal të plotë, me të gjitha pasojat që vijnë: detyrime procedurale, kufizime të jetës profesionale, ndikime në reputacion dhe barra financiare. Këto pasoja prodhohen në momentin e marrjes së vendimit dhe ekzistojnë pavarësisht nga rezultati i gjykimit në themel. Nëse vendimi është marrë në kundërshtim me të drejtën për t’u njohur me aktet e procedimit dhe për të pasur një mbrojtje efektive; të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur; cënimin e parimit të prezumimit të pafajësisë; si dhe të drejtën për t’u hetuar nga një prokuror i emëruar në përputhje me kriteret ligjore, atëherë i pandehuri i nënshtrohet gjykimit pa pasur të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi. Kjo shkelje nuk zhbëhet nga një vendim i mëvonshëm mbi fajësinë. Edhe pafajësia nuk rivendos dot të drejtat e mësipërme procedurale që i janë cenuar kërkuesit në momentin e hapjes së procesit të themelit përmes vendimit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjykim. Për këtë arsye, vendimi i seancës paraprake, ndonëse formalisht “i ndërmjetëm”, është materialisht “përfundimtar” për efekt të kontrollit kushtetues. Ai ka një autonomi funksionale nga vendimi i themelit, sepse gjykata që jep vendimin përfundimtar nuk ka kompetencë për të ndikuar mbi mënyrën e nxjerrjes së vendimit paraprak dhe as për të korrigjuar pasojat e tij. Kjo e vendos çështjen brenda kategorisë së përjashtimeve të pranuar nga GJK, ku ankimi kushtetues ndaj një vendimi të ndërmjetëm është i lejueshëm për shkak të natyrës dhe efekteve të tij.

34. Në përputhje me standardin e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, detyrimi për shterimin e mjeteve juridike lidhet jo me ekzistencën formale të mjeteve, por me efektivitetin e tyre, në kuptimin që ato duhet të jenë të “përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për çështjen konkrete” dhe “të afta për të rivendosur të drejtën e pretenduar si të shkelur”. Në rastin konkret, siç argumentuam më sipër, kërkuesi nuk ka asnjë mundësi ankimi, qoftë të veçantë, qoftë të bashkëlidhur me vendimin përfundimtar, ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës

paraprake. Kjo do të thotë se, në kuptimin e jurisprudencës së kësaj Gjykate, nuk bëhet fjalë për mjete “të pa shteruar”, por për mungesë të plotë të një mjeti efektiv, të aftë për të rivendosur cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në fazën e seancës paraprake. Në këto rrethana, kriteri i shterimit të mjeteve juridike është i përmbushur nga kërkuesi, pasi nuk ekziston asnjë rrugë tjetër juridike që i ai të ndjekë brenda sistemit të zakonshëm. Kjo e vendos qartazi çështjen brenda atyre rasteve të përjashtimit të pranuar tashmë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, ku vendimet e ndërmjetme u nënshtrohen kontrollit kushtetues për shkak të efekteve të tyre të drejtpërdrejta dhe të pakthyeshme ndaj të drejtave themelore.

35. Ndalimi i ankimit të parashikuar në nenin 332/gj të KPrP nuk mund të interpretohet si një dispozitë që i jep vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake imunitet nga kontrolli kushtetues, pra nuk mund të kuptohet si një normë që kufizon vetë juridiksionin kushtetues të përcaktuar në nenin 131/f të Kushtetutës. Përndryshe, një dispozitë e Kodit të Procedurës Penale do të ishte në gjendje të neutralizonte Kushtetutën dhe garancitë që ajo jep për të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pjesë e së cilës është e drejta e ankimit, duke krijuar një zonë procedurale të paprekshme nga çdo kontroll gjyqësor. Një interpretim i tillë do të ishte në kundërshtim me parimin e epërsisë së Kushtetutës dhe me detyrimin e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar që asnjë normë ligjore të mos kufizojë thelbin e të drejtave themelore përtej asaj që lejon neni 17 i saj.

36. Në rastin konkret, kërkuesi nuk ankohet për një rrezik abstrakt ose hipotetik, por për shkelje tashmë të konsumuara të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Kërkuesi gjendet tani përballë një gjykimi penal në themel, i çelur proceduralisht në mënyrë antikushtetuese. Në këtë kuadër, siç do të argumentojmë në vijim, shkeljet që ankimohen nuk përbëjnë thjesht mosrespektim të disa kërkesave formale të Kodit të Procedurës Penale, por cenim të drejtpërdrejtë të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Nëse Gjykata Kushtetuese do të refuzonte shqyrtimin e kësaj kërkesë me arsyetimin e mungesës së shterimit të mjeteve juridike ose me arsyetimin se ky vendim nuk është përfundimtar, praktikisht do të krijohej një situatë mosdhënieje drejtësie: asnjë gjykatë e zakonshme nuk do të kishte kompetencë për të konstatuar dhe korrigjuar këtë shkelje, ndërsa Gjykata Kushtetuese do të vetëpërfundonte duke iu referuar mjeteve që nuk ekzistojnë as ligjorisht. Një interpretim i tillë do ta zbrazte nga përmbajtja parimin e mbrojtjes kushtetuese efektive, i cili, kuptohet si garanci reale se nuk do të ketë asnjë zonë të “imunizuar” nga kontrolli gjyqësor.

III. Lidhur me legjitimimin për kërkimin e konstatimit të papajtueshmërisë me Kushtetutën të paragrafit të parë të nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale

37. Çështja e legjitimitimit *locus standi* të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

38. Kjo dispozitë kushtetuese është zbërthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, të ndryshuar që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a). Sipas pikës 2 të nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, nëse përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i tij, të cilat lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave dhe lirive kushtetuese, shterimin e të gjitha mjeteve juridike përkatëse dhe zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit objekt ankimi, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore.

39. Bazuar në përmbajtjen e normës kushtetuese dhe të normave ligjore, kur objekt i ankimit kushtetues individual është një ligj ose një akt normativ, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*).

40. Në kuptim të kritereve të mësipërme, kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës kushtetuese për t’u ankuar ndaj në vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, e cila sipas nenit 43 të Kushtetutës mund të kufizohet vetëm “kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”, rast para të cilit nuk jemi. Kërkuesi është i legjitimuar për të kërkuar kontrollin kushtetues dhe shfuqizimin e nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale, pasi cenimi i të drejtës për ankim të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës

buron drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht nga vetë përmbajtja normative e kësaj dispozite ligjore, e cila ndalon në mënyrë absolute ushtrimin e ankimit kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq. Norma e kundërshtuar është drejtpërdrejt e zbatueshme dhe prodhon efekt juridik automatik në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor, duke e vendosur kërkuesin në një situatë ku ai, privohet përfundimisht nga çdo mundësi për t'iu drejtuar një gjykate më të lartë për të kundërshtuar një vendim që e prek drejtpërdrejt në statusin e tij procedural dhe juridik.

41. Në këto rrethana, kërkuesi, nga vetë përmbajtja e normës ligjore të kundërshtuar, nuk ka në dispozicion ndonjë mjet juridik efektiv për mbrojtjen e së drejtës së cenuar, pasi vetë ligji objekt gjykimi përjashton çdo formë ankimi ose kontrolli gjyqësor mbi vendimin në fjalë, duke e bërë të pamundur shterimin e mjeteve juridike të zakonshme dhe duke përjashtuar çdo rrugë alternative brenda juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues nuk paraqitet si mjet i parakohshëm apo zëvendësues i mjeteve të tjera juridike, por si forma e vetme e mbrojtjes efektive që i ka mbetur kërkuesit përballë një norme ligjore që, për nga natyra dhe formulimi i saj, prodhon vetë cenimin kushtetues të pretenduar. Kërkuesi nuk vepron në mënyrë abstrakte ose në interes të përgjithshëm, por si subjekt konkret i një procesi penal, ndaj të cilit është zbatuar drejtpërdrejt norma e kundërshtuar dhe i cili, si pasojë e këtij zbatimi, është prekur realisht, aktualisht dhe personalisht në ushtrimin e një të drejte themelore, siç është e drejta kushtetuese për t'u ankuar ndaj në vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, çka e bën kërkesën e tij të përmbushë plotësisht kriteret e legjitimitimit të parashikuara nga neni 131, germa "F" e Kushtetutës dhe neni 49 i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

42. Gjithashtu, në rastin konkret dispozita ligjore e kundërshtuar nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e saj, por është drejtpërdrejt e zbatueshme ndaj kërkuesit, në këto kushte, kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion për të shteruar përveç paraqitjes së kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën, pra paraqitjes së ankimit kushtetues individual për rivendosjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar. (*Vendim nr. 31 datë 04.10.2021 i Gjykatës Kushtetuese*) Për më tepër, edhe sikur kërkuesi të kishte mundësi të ankohej në gjykatat e zakonshme, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se paraqitja e kërkesës për iniciimin e kontrollit incidental të normës nuk përbën element të domosdoshëm në këndvështrim të përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, megjithatë, si një formë jo e drejtpërdrejtë e aksesit në gjykimin kushtetues, palët në proces mund të zgjedhin t'i kërkojnë gjykatës së zakonshme që të investojë Gjykatën Kushtetuese. (*Vendim nr. 4 datë 21.02.2022 i Gjykatës Kushtetuese*)

43. Lidhur me afatin ligjor të paraqitjes së kërkesës, bazuar në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ajo duhet të paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Gjykata

Kushtetuese ka vlerësuar se në rastin e ankimit kushtetues individual konstatimi i cenimit si rregull nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ. Në këto raste afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ. (Vendim nr. 31 datë 04.10.2021 i Gjykatës Kushtetuese) Në këtë kuptim, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, pra përmbush edhe kriterin e legjitimitimit *ratione temporis*.

IV. Lidhur me legjitimin për kërkimin e konstatimit të papajtueshmërisë me kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr. 95, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

44. Njëjtë si më sipër, kërkuesi legjitimohet për të kërkuar konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr. 95, datë 6.10.2016, pasi cenimi i të drejtës së tij për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme buron drejtpërdrejt nga përmbajtja dhe efektet e kësaj dispozite ligjore. Në rastin konkret, kërkuesi nuk kundërshton normën në mënyrë abstrakte, por në funksion të drejtpërdrejtë të çështjes së tij, pasi gjykimi ndaj tij është zhvilluar nga një gjyqtare e gjykatës së posaçme, e cila, për shkak të nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, ndodhet në një raport të drejtpërdrejtë varësie dhe ekspozimi ndaj kompetencës hetimore dhe ndjekëse të Prokurorisë së Posaçme. Dispozita e kundërshtuar i njeh prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kompetencën për të hetuar dhe ndjekur penalisht edhe gjyqtarët e gjykatave të posaçme. Kjo krijon një situatë objektive konflikti interesi dhe presioni për gjyqtarët, pasi gjyqtari që shqyrton çështjen është njëkohësisht subjekt i mundshëm i ndjekjes penale nga pala në proces, që është Prokuroria e Posaçme.

45. Në këto kushte, marrëdhënia ndërmjet organit të akuzës dhe gjykatës nuk është më një marrëdhënie e balancuar institucionale, por një raport që cenon në mënyrë strukturore pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatës. Edhe në mungesë të një prove konkrete për ndikim të drejtpërdrejtë, ekzistenca e një kompetence të tillë krijon një perceptim objektiv të mungesës së paanshmërisë, që është i mjaftueshëm për të cenuar standardet kushtetuese dhe konventore të një procesi të rregullt ligjor. Pikërisht për këtë arsye, cenimi i pretenduar nga kërkuesi nuk është hipotetik, por aktual dhe konkret, pasi buron nga vetë kuadri ligjor që ka rregulluar funksionimin e gjykatës që ka shqyrtuar çështjen e tij. Neni 14 i ligjit nr. 95/2016 ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta në cilësinë e gjykimit, duke prekur garancinë themelore të gjyqtarit të pavarur dhe të paanshëm. Në këtë kuptim, kërkuesi ka interes personal, të drejtpërdrejtë dhe

aktual për të kërkuar kontrollin e përputhshmërisë së kësaj dispozite me Kushtetutën, pasi vetëm përmes këtij kontrolli mund të rivendoset e drejta e tij për një proces të rregullt ligjor.

46. Po ashtu, kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptimin që ka përdorur të gjitha mjetet që janë të afta për të mbrojtur të drejtat e tij në kuadrin e juridiksionit të zakonshëm, duke bërë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës. Në këto kushte, kërkuesi përmbush të gjitha kriteret për legjitimin aktiv në kërkimin e konstatimit të papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, pasi kjo dispozitë ka krijuar një situatë objektive që cenon pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatës që ka gjykuar çështjen e tij dhe, rrjedhimisht, të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor.

V. Lidhur me themelin e pretendimeve për shkeljen e të drejtave kushtetuese nga vendimi gjyqësor objekt shqyrtimi

i. Lidhur me cënimin e së drejtës së kërkuarit për t'u njohur personalisht me aktet e çështjes penale në ngarkim të tij, si dhe cënimin e së drejtës për mbrojtje efektive

47. Gjatë të gjithë gjykimit, nga ana e z. Veliaj dhe mbrojtjes së tij janë ngritur në mënyrë të vazhdueshme pretendime lidhur me vendosjen në dispozicion të z. Veliaj të të gjitha akteve dhe provave në ngarkim të tij me qëllim që ai personalisht të mund të njihej me to, brenda një periudhe të arsyeshme. Më konkretisht, z. Veliaj ka kërkuar të ketë akses të plotë, të pakufizuar dhe real, si dhe kohën e kushtet e nevojshme për të lexuar aktet, provat dhe çdo deklaram mbi të cilat është ndërtuar akuza në ngarkim të tij dhe që e ka vendosur në izolim atë. Z. Veliaj ka pretenduar gjatë të gjithë procesit se atij personalisht, nuk i është vënë ende në dispozicion një kopje fizike e akteve, si dhe koha minimale për t'u njohur me një akuzë të ndërtuar mbi rreth 62 mijë faqe, duke i bërë praktikisht të pamundur ushtrimin e së drejtës së tij kushtetuese për t'u mbrojtur.

48. Mbrojtësja e caktuar kryesisht nga gjykata deklaroi në seancën e datës 19.01.2026 se deri më datë 18.01.2026 kishte qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, për pasojë, nuk kishte pasur asnjë takim me kërkuarin dhe asnjë mundësi reale për t'u njohur me aktet dhe provat në ngarkim të tij. Pavarësisht kësaj situatë objektive, gjykata vendosi shtyrjen e seancës për datën 02.02.2026, duke supozuar se brenda këtij afati mbrojtësja mund të njihte dhe përvetësonte një material hetimor më shumë se 60.000 faqesh dhe të realizonte konsultimin përkatës me klientin. Një pritshmëri e tillë është qartazi jorealiste dhe në kundërshtim me çdo standard të mbrojtjes praktike dhe efektive, duke e reduktuar të drejtën për mbrojtje në një

formalitet të zbrazët. Nuk mjafton që gjykata të përcaktojë një afat, por afati duhet të jetë realist, i arsyeshëm dhe funksional, duke marrë parasysh: volumin e dosjes, kompleksitetin e çështjes, natyrën e provave, ndikimin e provave në të drejtën e mbrojtjes, kohën reale në dispozicion të të pandehurit. Një proces ku mbrojtja nuk ka kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur, nuk është proces i drejtë, pavarësisht se sa "formalisht" është respektuar procedura. Asnjë akt juridik nuk parashikon që për interesa të "shpejtësisë së procedimit", gjykata mund të kufizojë këtë të drejtë në atë masë sa të bëhet iluzionare. Vendosja e një afati të pamundur për leximin e materialeve përbën një kufizim të së drejtës së mbrojtjes që nuk kalon testin e proporcionalitetit.

49. Në rastin konkret, e drejta e të pandehurit për mbrojtje efektive është cenuar në mënyrë të qartë dhe objektive. Avokati i caktuar kryesisht nuk ka pasur njohje reale me aktet e fashikullit penal, nuk i ka lexuar ato dhe, për pasojë, nuk ka qenë në gjendje të kundërshtojë në mënyrë substanciale bazën faktike dhe juridike mbi të cilën është vendosur masa e sigurimit. Një mbrojtje e tillë, e kufizuar në prani formale, por e zhveshur nga përmbajtja reale, nuk përmbush standardin e mbrojtjes efektive të kërkuar nga ligji. Kjo situatë nuk ka qenë dhe nuk është e korigjueshme nga vetë i pandehuri. Aktet e procedimit ndodhen në format elektronik (USB), ndërkohë që në institucionin e paraburgimit nuk ekzistojnë mjetet teknike për t'i aksesuar ato. Si rrjedhojë, gjatë të gjithë zhvillimit të procesit përpara gjyqtarit të seancës paraprake, i pandehuri ka qenë në pamundësi objektive për t'u njohur me provat në ngarkim, për të ndërtuar linjën e mbrojtjes dhe për të orientuar në mënyrë të informuar përfaqësimin e tij ligjor. Në këto kushte, e drejta për mbrojtje mbetet teorike dhe jo praktike. Pasojë direkte e kësaj situatë është fakti se masa e sigurimit ka vijuar dhe vijon të zbatohet pa u testuar realisht përballë një kundërshtimi efektiv. Gjykata është vënë në kushtet e një procesi formalisht kontradiktor, por materialisht të pabalancuar, ku mbrojtja nuk ka pasur mundësi reale të përballet me akuzën në nivel provash.

50. Neni 6 § 3 (b) i KEDNJ përcakton: "*3. Çdokush i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: ... (b) të ketë kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;*". **Ky formulim përbën një garanci themelore procedurale**, e cila nuk lidhet vetëm me fazën e gjykimit në kuptimin e ngushtë, por shtrihet në çdo fazë të procedurës penale ku pozicioni i të akuzuarit mund të ndikohet realisht nga mungesa e kohës ose e mjeteve për përgatitjen e mbrojtjes. **E drejta për "kohë dhe lehtësira" nuk është abstrakte, por kërkon vlerësim konkret të kushteve në të cilat i akuzuari ndodhet.** "Të drejtat e mbrojtjes", të cilat Neni 6 § 3 (b) jep një listë jo të plotë, janë krijuar mbi të gjitha për të vendosur barazi, për aq sa është e mundur, midis prokurorisë dhe mbrojtjes. **Në këtë kuptim, parimi i barazisë së armëve shërben si kriter udhëheqës për interpretimin e nenit 6 § 3**

(b): çdo kufizim që vendos mbrojtjen në një pozicion dukshëm më të pafavorshëm se organi i akuzës cenon vetë arsyen e ekzistencës së kësaj garancie. **GJEDNJ ka theksuar se barazia procedurale nuk arrihet përmes formalizmit, por përmes mundësisë reale për të përgatitur dhe paraqitur mbrojtjen.**

51. Neni 6 § 3 (b) i Konventës trajton dy elementë të një mbrojtjeje të duhur, përkatësisht çështjen e lehtësirave dhe atë të kohës. Kjo dispozitë nënkupton që aktiviteti thelbësor i mbrojtjes në emër të të akuzuarit mund të përfshijë gjithçka që është "e nevojshme" për të përgatitur gjyqin. I akuzuari duhet të ketë mundësinë të organizojë mbrojtjen e tij në një mënyrë të përshtatshme dhe pa kufizime në lidhje me aftësinë për të paraqitur të gjitha argumentet përkatëse të mbrojtjes para gjykatës së shkallës së parë dhe kështu për të ndikuar në rezultatin e procedurave (*Can kundër Austrisë, raporti i Komisionit i 12 korrikut 1984, § 53; Gregačević kundër Kroacisë, 2012, § 51*). **Këto dy elementë janë të pandashëm: koha e mjaftueshme humbet çdo kuptim nëse mungojnë lehtësirat praktike për përgatitjen e mbrojtjes, dhe anasjelltas. GJEDNJ ka sqaruar se nocioni i “gjithçkaje që është e nevojshme” përfshin jo vetëm kohën kalendarike, por edhe mundësinë reale për të studiuar materialin e çështjes dhe për të strukturuar argumentimin mbrojtës në mënyrë efektive.**

52. Kur vlerësohet nëse i akuzuari kishte kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë natyrës së procedurave, si dhe kompleksitetit të çështjes dhe fazës së procedurave (*Gregačević kundër Kroacisë, 2012, § 51*). **Ky vlerësim është thelbësisht kontekstual dhe individual, dhe nuk mund të bazohet në standarde abstrakte apo në afate formale të paracaktuara. Sa më komplekse të jetë çështja dhe sa më vendimtare të jenë pasojat për të akuzuarin, aq më i lartë është standardi i kërkuar për kohën reale të vënë në dispozicion të mbrojtjes.** Edhe pse është e rëndësishme të zhvillohen procedurat me një shpejtësi të mirë, kjo nuk duhet të bëhet në kurriz të të drejtave procedurale të njëjës prej palëve (*OAO Neftyanaya Kompaniya Yukos kundër Rusisë, 2011, § 540*). **GJEDNJ ka bërë të qartë se efikasiteti procedural nuk mund të justifikojë cenimin e garancive themelore të mbrojtjes:** shpejtësia e procedurës nuk është një vlerë absolute, por një interes që duhet të balancohet me respektimin e plotë të të drejtave të të akuzuarit. **Kur ky balancim dështon, procedura mund të jetë formalisht e shpejtë, por materialisht e padrejtë.**

53. Në përcaktimin nëse Neni 6 § 3 (b) është përmbushur, duhet të merret parasysh edhe ngarkesa e zakonshme e punës së këshilltarit ligjor; megjithatë, nuk është e paarsyeshme të kërkohet që një avokat mbrojtës të organizojë të paktën një ndryshim në theksin e punës së tij nëse kjo është e nevojshme duke pasur parasysh urgjencën e veçantë të një çështjeje të caktuar (*Mattick kundër Gjermanisë (vendim), 2005*). Në këtë kontekst, në një çështje në të cilën

aplikanti dhe avokati i tij mbrojtës kishin pasur pesë ditë për të studiuar një dosje çështjeje me gjashtë vëllime prej rreth 1.500 faqesh, Gjykata nuk e konsideroi kohën e caktuar për mbrojtjen për të studiuar dosjen e çështjes të mjaftueshme për të mbrojtur thelbin e të drejtës së garantuar nga Neni 6 §§ 1 dhe 3 (b). **Ky standard bëhet edhe më kërkues kur dosja penale ka një volum jashtëzakonisht të lartë**, si në rastin konkret, ku fashikulli gjyqësor përbëhet nga rreth **60.000 faqe**. Duke iu referuar praktikës profesionale dhe logjikës së ndjekur nga GJEDNJ në çështje si *Mattick*, *Lambin* apo *Nevzlin*, **leximi juridik efektiv nuk mund të reduktohet në një lexim mekanik**, por përfshin analizën e provave, krahasimin e akteve, ndërtimin e lidhjeve faktike dhe juridike dhe formulimin e strategjisë mbrojtëse.

54. Në kushte normale pune, **një avokat mbrojtës nuk mund të përpunojë realisht më shumë se rreth 80–120 faqe në ditë**, edhe kur ka akses të plotë, përqendrim të pandërprerë dhe pa kufizime teknike. Në këto rrethana, **studimi minimal dhe funksional i një dosjeje prej 60.000 faqesh kërkon ndërmjet 500 dhe 750 ditë pune efektive**, që përkthehet në **rreth 2 deri në 3 vite pune të vazhdueshme**, pa llogaritur kohën shtesë për konsultime me të pandehurin, hartimin e parashtrësave dhe reagimin ndaj zhvillimeve procedurale. **Nëse merret në konsideratë edhe nevoja që i pandehuri vetë të njihet me materialin provues**, në mënyrë që të orientojë mbrojtjen e tij, kjo kohë shumëfishohet, pasi një person pa akses të drejtpërdrejtë dhe pa mjete teknike nuk mund të përthithë më shumë se disa dhjetëra faqe në ditë. **Në kushtet e paraburgimit, këto përlllogaritje bëhen edhe më restriktive**, pasi i pandehuri nuk ka akses të lirë në dosje, nuk disponon pajisje elektronike për materialet në format dixhital, dhe konsultimet me avokatin janë të kufizuara në kohë dhe frekuencë. **Kjo do të thotë se paraburgimi nuk kufizon vetëm lirinë personale, por redukton në mënyrë drastike kapacitetin real për përgatitjen e mbrojtjes**, duke e bërë objektivisht të pamundur përmbushjen e standardit të Nenit 6 § 3 (b). Për rrjedhojë, **vazhdimi i masës së arrestit në burg në një çështje me një volum të tillë provash prodhon një disbalancë procedurale strukturore**, që cenon thelbin e të drejtës për mbrojtje efektive dhe e zhvesh këtë masë nga justifikimi i saj konventor.

55. Rrjedha e gjyqeve nuk mund të parashikohet plotësisht paraprakisht dhe mund të zbulojë elementë që nuk kishin dalë në dritë deri më tani dhe kërkojnë përgatitje të mëtejshme nga palët (*Mattick kundër Gjermanisë (vendim)*, 2005). **Ky parim nënkupton se e drejta për kohë të mjaftueshme nuk shteron në një moment të vetëm procedural**, por është një **garanci dinamike**, që duhet të ri-vlerësohet sa herë që procedura evoluon. **Kur shfaqen elemente të reja ose ndryshon konteksti procedural, mbrojtja duhet të ketë mundësi reale për t'u përshtatur dhe për të riformuluar qëndrimin e saj.**

56. Një çështje në lidhje me kërkesën për "kohë të mjaftueshme" sipas Nenit 6 § 3 (b) mund të lindë në lidhje me kohën e kufizuar për inspektimin e një dosjeje (*Huseyn dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit, 2011, § 174-178; Iglin kundër Ukrainës, 2012, §§ 70-73; shih Nevzlin kundër Ruisë, 2022, §§ 144-150, ku mbrojtjes iu dhanë dy javë, që përfshinin fundjavat dhe festat, për të shqyrtuar një dosje çështjeje prej 19,000 faqesh që përfshinte akuza në lidhje me disa episode vrasjeje dhe tentativë vrasjeje), ose një periudhë të shkurtër midis njoftimit të akuzave dhe mbajtjes së seancës dëgjimore (Vyerentsov kundër Ukrainës, 2013, §§ 75-77). Për më tepër, mbrojtjes duhet t'i jepet kohë shtesë pas ngjarjeve të caktuara në procedurë, në mënyrë që të rregullojë qëndrimin e saj, të përgatisë një kërkesë, të paraqesë një ankesë, etj. (Miminoshvili kundër Ruisë, 2011, § 141). "Ndodhi" të tilla mund të përfshijnë ndryshime në aktakuzë (Pélissier dhe Sassi kundër Francës (GC), 1999, § 62), futjen e provave të reja nga prokuroria (G.B. kundër Francës, 2001, §§ 60-62), ose një ndryshim të papritur dhe drastik në mendimin e një eksperti gjatë gjyqit (*ibid.*, §§ 69-70). **Kjo jurisprudencë konfirmon se "koha e mjaftueshme" vlerësohet në raport me volumet reale të dosjes dhe ngjarjet procedurale konkrete, jo mbi afate formale. Kur materiali është i gjerë, kompleks ose ndryshon gjatë procedurës, mosdhënia e kohës shtesë cenon drejtpërdrejt aftësinë e mbrojtjes për të reaguar në mënyrë efektive.***

57. Një i pandehur pritët të kërkojë një shtyrje ose shtyrje të një seance dëgjimore nëse ka një problem të perceptuar me kohën e lejuar (*Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1984, § 98; Bäckström dhe Andersson kundër Suedisë (vendim), 2006; Craxi kundër Italisë (nr. 1), 2002, § 72*). **Megjithatë, kjo pritshmëri nuk e zhvendos përgjegjësinë kryesore mbi të pandehurin, por shërben si një element vlerësimi në analizën e përgjithshme të drejtësisë së procedurës. Ajo nuk mund të interpretohet si heqje dorë nga e drejta për kohë të mjaftueshme, veçanërisht kur kufizimet janë objektive ose strukturore.** Në rrethana të caktuara, një gjykatë mund të detyrohet të shtyjë një seancë dëgjimore me nismën e saj në mënyrë që t'i japë mbrojtjes kohë të mjaftueshme (*Sadak dhe të tjerë kundër Turqisë (nr. 1), 2001, § 57; Sakhnovskiy kundër Ruisë (GC), 2010, §§ 103 dhe 106*). **Kjo nënvizon ekzistencën e një detyrimi pozitiv të gjykatës, që shkon përtej rolit pasiv arbitral: kur është e dukshme se mbrojtja nuk ka pasur kohë reale dhe të mjaftueshme, gjykata duhet të ndërhyjë ex officio. Mosushtimi i kësaj kompetence në rrethana të tilla cenon thelbin e nenit 6 § 3 (b) dhe ndikon drejtpërdrejt në drejtësinë e procedurës.**

58. "Lehtësitet" që duhet të gëzojë çdo i akuzuar për një vepër penale përfshijnë mundësinë për t'u njohur, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së tij, me rezultatet e hetimeve të kryera gjatë gjithë procedurave (*Huseyn dhe të tjerë kundër Azerbajxhanit, 2011, § 175; OAO Neftyanaya*

Kompaniya Yukos kundër Rosisë, 2011, § 538). **Ky element përbën përmbajtjen minimale të nocionit të "lehtësirave" sipas Nenit 6 § 3 (b)**, pasi pa njohjen reale të materialit hetimor, përgatitja e mbrojtjes mbetet iluzore. **GJEDNJ ka theksuar se kjo e drejtë nuk kufizohet në akses formal**, por kërkon që i akuzuari të jetë në gjendje të kuptojë dhe të përdorë në mënyrë efektive informacionin e përfshirë në dosje për të ndërtuar qëndrimin e tij mbrojtës.

59. Detyrimi i Shteteve sipas Nenit 6 § 3 (b) për të siguruar të drejtën e të akuzuarit për të ngritur një mbrojtje në procedurat penale përfshin një detyrim për të organizuar procedurat në një mënyrë të tillë që të mos dëmtojë fuqinë e të akuzuarit për t'u përqendruar dhe për të përdorur shkathtësinë mendore në mbrojtjen e pozicionit të tij. Kur të pandehurit janë të paraburgosur, kushtet e paraburgimit të tyre, transporti, ushqimi dhe rregullime të tjera të ngjashme janë faktorë të rëndësishëm që duhen marrë në konsideratë në këtë drejtim (*Razvozhayev kundër Rosisë dhe Ukrainës dhe Udaltsov kundër Rosisë, 2019, § 252*). **Ky standard e zhvendos analizën nga forma procedurale te realiteti praktik i ushtrimit të mbrojtjes**, duke e lidhur drejtpërdrejt Nenit 6 § 3 (b) me **kushtet materiale të paraburgimit**. **GJEDNJ ka bërë të qartë se, kur shteti zgjedh të mbajë një person në paraburgim, ai merr mbi vete përgjegjësinë për të garantuar që këto kushte të mos dëmtojnë kapacitetin e tij intelektual dhe fizik për të marrë pjesë në mbrojtje.**

60. Në veçanti, kur një person është i ndaluar në pritje të gjyqit, nocioni i "lehtësirave" mund të përfshijë kushte të tilla të ndalimit që i lejojnë personit të lexojë dhe të shkruajë me një shkallë të arsyeshme përqendrimi (*Mayzit kundër Rosisë, 2005, § 81; Moiseyev kundër Rosisë, 2008, § 221*). Është thelbësore që si i akuzuari ashtu edhe avokati i tij mbrojtës të jenë në gjendje të marrin pjesë në procedurat dhe të bëjnë parashtrësia pa vuajtur nga lodhja e tepërt (*Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, 1988, § 70; Makhfi kundër Francës, 2004, § 40; Fakailo (Safoka) dhe të tjerë kundër Francës, 2014, § 50*). Kështu, në *Razvozhayev kundër Rosisë dhe Ukrainës dhe Udaltsov kundër Rosisë, 2019, §§ 253-254*, Gjykata konstatoi se efekti kumulativ i lodhjes së shkaktuar nga transferimet e gjata në burg, në kushte të këqija dhe me më pak se tetë orë pushim, të përsëritura për katër ditë në javë gjatë një periudhe prej më shumë se katër muajsh, dëmtoi seriozisht aftësinë e aplikantit për të ndjekur procedurat, për të bërë parashtrime, për të mbajtur shënime dhe për të udhëzuar avokatët e tij. Në këto rrethana, dhe duke pasur parasysh se nuk i ishte dhënë konsideratë e mjaftueshme kërkesave të aplikantit për një orar seancash që mund të kishte qenë më pak intensiv, Gjykata konsideroi se atij nuk i ishin ofruar lehtësira të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, gjë që kishte dëmtuar kërkesat e një gjykimi të drejtë dhe barazisë së armëve, në kundërshtim me kërkesat e Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (b) të Konventës.

61. Ky arsyetim tregon se “lehtësirat” nuk janë koncept abstrakt, por lidhen drejtpërdrejt me gjendjen fizike dhe mendore të të pandehurit gjatë procedurës. Kur lodhja, kushtet e ndalimit ose organizimi i seancave e bëjnë praktikisht të pamundur përqendrimin dhe bashkëpunimin me mbrojtjen, cenimi i Nenit 6 § 3 (b) është i pashmangshëm. Lehtësitë që duhet t'i jepen të akuzuarit janë të kufizuara në ato që e ndihmojnë ose mund ta ndihmojnë atë në përgatitjen e mbrojtjes së tij (*Padin Gestoso kundër Spanjës (vendim), 1999; Mayzit kundër Ruisë, 2005, § 79*). Ky kufizim nuk e dobëson standardin, por thekson se çdo masë duhet të vlerësohet sipas ndikimit të saj konkret në aftësinë mbrojtëse. Në disa raste, kjo mund të lidhet me nevojën për t'i siguruar aplikantit mundësinë për të marrë prova në favor të tij (*Lilian Erhan kundër Republikës së Moldavisë, §§ 20-21*). Garancitë e Nenit 6 § 3 (b) kanë rëndësi edhe për aksesin e të pandehurit në dosje dhe zbulimin e provave, dhe në këtë kontekst ato përputhen me parimet e barazisë së armëve dhe gjykimit kundërshtar sipas Nenit 6 § 1 (*Rowe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar (GC), 2000, § 59; Leas kundër Estonisë, 2012, § 76*).

62. Një i pandehur nuk ka nevojë t'i jepet akses i drejtpërdrejtë në dosjen e çështjes, mjafton që ai të informohet për materialin në dosje nga përfaqësuesit e tij (*Kremzow kundër Austrisë, 1993, § 52*). Megjithatë, ky parim nuk mund të përdoret për të justifikuar kufizime që, në praktikë, e privojnë mbrojtjen nga mundësia për të reaguar ndaj provave. Aksesin e kufizuar i një të pandehuri në dosjen e gjykatës nuk duhet të pengojë që provat t'i vihen në dispozicion të pandehurit para gjyqit dhe t'i jepet të pandehurit mundësia për të komentuar mbi to përmes avokatit të tij në parashtrimet me gojë (*Öcalan kundër Turqisë (GC), 2005, § 140*). Për të lehtësuar kryerjen e mbrojtjes, i akuzuari nuk duhet të pengohet në marrjen e kopjeve të dokumenteve përkatëse nga dosja e çështjes dhe në mbledhjen dhe përdorimin e çdo shënimi të marrë (*Rasmussen kundër Polonisë, 2009, §§ 48-49; Moiseyev kundër Ruisë, 2008, §§ 213-218; Matyjek kundër Polonisë, 2007, § 59; Seleznev kundër Ruisë, 2008, §§ 64-69*).

63. "Lehtësitë" që i ofrohen një të akuzuari përfshijnë konsultimin me avokatin e tij (*Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1984, § 99; Goddi kundër Italisë, 1984, § 31*). Mundësia që një i akuzuar të këshillohet me avokatin e tij mbrojtës është thelbësore për përgatitjen e mbrojtjes së tij (*Bonzi kundër Zvicrës, vendimi i Komisionit i 12 korrikut 1978; Can kundër Austrisë, raporti i Komisionit i 12 korrikut 1984, § 52*). Kjo e drejtë duhet të jetë reale dhe efektive, jo formale, dhe çdo pengesë fizike ose organizative që e bën konsultimin joefektiv bie ndesh me Nenit 6 § 3 (b). Kështu, lind një çështje sipas Nenit 6 § 3 (b) nëse vendosja e një të akuzuari në një kabinë xhami gjatë seancës dëgjimore pengon konsultimin e tij ose të saj efektiv me një avokat (*Yaroslav Belousov kundër Ruisë, 2016, §§ 148-153*).

GJEDNJ ka theksuar se komunikimi me avokatin duhet të jetë praktikisht i mundshëm gjatë gjithë procedurës, përndryshe garancia e mbrojtjes efektive zbrazet nga përmbajtja e saj.

64. Çdo person që i nënshtrohet një akuze penale duhet të mbrohet nga Neni 6 § 3 (c) në çdo fazë të procedurës (*Imbrioscia kundër Zvicrës, 1993, § 37*). Kjo mbrojtje mund të bëhet e rëndësishme edhe para se një çështje të dërgohet për gjykim nëse dhe për aq sa drejtësia e gjykimit ka të ngjarë të dëmtohet seriozisht nga një dështim fillestar për të përmbushur dispozitat e Nenit 6 (*Öcalan kundër Turqisë (GC), 2005, § 131; Ibrahim dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (GC), 2016, § 253; Magee kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2000, § 41*). **Ky standard e koncepton të drejtën për ndihmë ligjore si një garanci të vazhdueshme, jo të kufizuar vetëm në seancën gjyqësore, por të zbatueshme në çdo fazë ku merren vendime që mund të ndikojnë në mënyrë të pakthyeshme pozicionin procedural të të akuzuarit. GJEDNJ ka theksuar se mangësitë e fazës paraprake nuk “shërohen” automatikisht në gjykim, nëse ato kanë cenuar drejtësinë e procesit në tërësi.**

65. Ndërsa Neni 6 § 3 (b) është i lidhur me konsiderata që lidhen me përgatitjen e gjyqit, Neni 6 § 3 (c) i jep të akuzuarit një të drejtë më të përgjithshme për ndihmë dhe mbështetje nga një avokat gjatë gjithë procedurës (*Can kundër Austrisë, raporti i Komisionit i 12 korrikut 1984, § 54*). Megjithatë, mënyra se si duhet të zbatohet Neni 6 § 3 (c) në fazën paraprake të gjyqit (gjatë hetimit paraprak) varet nga tiparet e veçanta të procedurave të përfshira dhe nga rrethanat e çështjes (*Ibrahim dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (GC), 2016, § 253; Brennan kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2001, § 45; Berliński kundër Polonisë, 2002, § 75*). **Ky dallim nuk e relativizon të drejtën, por kërkon një analizë funksionale: sa herë që mungesa e ndihmës ligjore në fazën hetimore ndikon në aftësinë e të akuzuarit për të mbrojtur veten më vonë, garancitë e Nenit 6 § 3 (c) aktivizohen plotësisht.**

66. E drejta e një të pandehuri për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një gjykim penal përfshin, në përgjithësi, jo vetëm të drejtën për të qenë i pranishëm, por edhe të drejtën për të marrë ndihmë ligjore, nëse është e nevojshme (*Lagerblom kundër Suedisë, 2003, § 49; Galstyan kundër Armenisë, 2007, § 89*). Në të njëjtën mënyrë, vetëm prania e avokatit të aplikantit nuk mund të kompensojë mungesën e të pandehurit (*Zana kundër Turqisë (GC), 1997, § 72*). **GJEDNJ ka theksuar se pjesëmarrja “efektive” është një koncept substancial, që kërkon ndërveprim real midis të pandehurit dhe mbrojtjes së tij. As prania fizike e njërit dhe as e tjetrit, e marrë veçmas, nuk mjafton për të garantuar drejtësinë e procedurës. Që e drejta për ndihmë ligjore të jetë praktike dhe efektive, dhe jo thjesht teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të varet nga përmbushja e kushteve tepër formale: është detyrë e gjykatave të sigurojnë**

që një gjykim të jetë i drejtë dhe, në përputhje me rrethanat, që avokatit që merr pjesë në gjyq me qëllimin e dukshëm të mbrojtjes së të pandehurit në mungesë të tij, t'i jepet mundësia ta bëjë këtë (*Van Geysseghem kundër Belgjikës (GC), 1999, § 33; Pelladoah kundër Holandës, 1994, § 41*). **Ky standard i jep gjykatës një rol aktiv në garantimin e mbrojtjes**, duke e bërë të papranueshme çdo qasje formaliste që sakrifikon substancën e së drejtës në emër të rregullave procedurale.

67. Në përcaktimin nëse interesat e drejtësisë kërkojnë që një i pandehuri të pajiset me përfaqësim ligjor falas, Gjykata merr në konsideratë kritere të ndryshme, duke përfshirë seriozitetin e veprës penale dhe ashpërsinë e dënimit në fjalë. Në parim, kur është në rrezik privimi nga liria, interesat e drejtësisë kërkojnë përfaqësim ligjor (*Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar (GC), 1996, § 61; Quaranta kundër Zvicrës, 1991, § 33; Zdravko Stanev kundër Bullgarisë, 2012, § 38*). **Ky është një standard pothuajse automatik: kur liria personale është në lojë, mungesa e ndihmës ligjore përbën rrezik serioz për drejtësinë e procedurës**, pavarësisht nga kompleksiteti i dukshëm i çështjes.

68. E drejta për ndihmë efektive ligjore përfshin, ndër të tjera, të drejtën e të pandehurit për të komunikuar me avokatin e tij privatisht. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme Shteti mund të kufizojë kontaktin konfidencial midis një personi në paraburgim dhe avokatit të tij mbrojtës (*Sakhnovskiy kundër Rusisë (GC), 2010, § 102*). Nëse një avokat nuk është në gjendje të konsultohet me klientin e tij dhe të marrë udhëzime konfidenciale prej tij pa mbikëqyrje, ndihma e tij humbet shumë nga dobia e saj (*S. kundër Zvicrës, 1991, § 48; Brennan kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2001, § 58*). Çdo kufizim në marrëdhëniet midis klientëve dhe avokatëve, qoftë i natyrshëm apo i shprehur, nuk duhet të pengojë **ndihmën efektive ligjore** për të cilën ka të drejtë një i pandehur (*Sakhnovskiy kundër Rusisë (GC), 2010, § 102*). **Konfidencialiteti i komunikimit nuk është privilegj, por kusht themelor i mbrojtjes efektive**, dhe çdo cenim i tij kërkon justifikim shumë të fortë nga shteti. Neni 6 § 3 (c) sanksionon të drejtën për ndihmë ligjore "**praktike dhe efektive**". Thjesht, emërimi i një avokati të ndihmës ligjore nuk siguron ndihmë efektive, pasi avokati i caktuar mund të vdesë, të sëmuret rëndë, të pengohet për një periudhë të zgjatur të veprës ose të shmangë detyrat e tij (*Artico kundër Italisë, 1980, § 33; Vamvakas kundër Greqisë (nr. 2), 2015, § 36*). **GJEDNJ ka theksuar se shteti nuk e përmbush detyrimin e tij me një akt formal emërimi**, nëse në praktikë mbrojtja nuk realizohet.

69. Megjithatë, një Shtet Kontraktues nuk mund të mbahet përgjegjës për çdo mangësi nga ana e një avokati të caktuar për qëllime ndihme juridike ose të zgjedhur nga i pandehuri (*Lagerblom kundër Suedisë, 2003, § 56; Kamasinski kundër Austrisë, 1989, § 65*). Për shkak

të pavarësisë së profesionit ligjor, kryerja e mbrojtjes është në thelb një çështje midis të pandehurit dhe përfaqësuesit të tij; Shtetet Kontraktuese janë të detyruara të ndërhyjnë **vetëm nëse një dështim nga ana e avokatit për të ofruar përfaqësim efektiv është i dukshëm ose është sjellë në vëmendjen e tyre në mënyrë të mjaftueshme** (*Imbrioscia kundër Zvicrës, 1993, § 41; Daud kundër Portugalisë, 1998, § 38*). Përgjegjësia e shtetit mund të lindë kur një avokat thjesht nuk vepron në emër të të akuzuarit (*Artico kundër Italisë, 1980, §§ 33 dhe 36*) ose kur ai nuk përmbush një kërkesë thelbësore procedurale që nuk mund të barazohet thjesht me një linjë mbrojtjeje të pamatur ose një defekt të thjeshtë argumentimi (*Czekalla kundër Portugalisë, 2002, §§ 65 dhe 71*). **Ky prag i përgjegjësisë së shtetit synon të balancojë pavarësinë e profesionit ligjor me detyrimin pozitiv për të garantuar një proces realisht të drejtë.**

70. Barazia e armëve është një tipar i natyrshëm i një gjykimi të drejtë. Ajo kërkon që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh kundrejt kundërshtarit të saj (*Öcalan kundër Turqisë (GC), 2005, § 140; Foucher kundër Francës, 1997, § 34; Bulut kundër Austrisë, 1996; Faig Mammadov kundër Azerbajxhanit, 2017, § 19*). Barazia e armëve kërkon që të arrihet një ekuilibër i drejtë midis palëve dhe zbatohet në çështjet penale dhe civile. **Ky parim nuk kërkon identitet formal të mjeteve midis palëve**, por garantimin e një **mundësie reale dhe efektive** për secilën palë që të paraqesë argumentet dhe provat e saj. **GJEDNJ ka theksuar se disavantazhi procedural vlerësohet në terma praktikë**, duke marrë në konsideratë efektin konkret që kufizimet kanë mbi aftësinë e mbrojtjes për t'u përballur me akuzën.

71. E drejta për një gjykim kundërshtar është e lidhur ngushtë me barazinë e armëve dhe në të vërtetë në disa raste Gjykata gjen shkelje të Nenit 6 § 1 duke i parë të dy konceptet së bashku. Barazia e armëve mund të shkelet edhe kur i akuzuari ka akses të kufizuar në dosjen e çështjes së tij ose në dokumente të tjera për arsye të interesit publik (*Matyjek kundër Polonisë, 2007, § 65; Moiseyev kundër Ruisë, 2008, § 217*). **Gjykimi kundërshtar presupozon njohjen efektive të materialeve mbi të cilat mbështetet akuza**, dhe çdo kufizim në këtë drejtim duhet të vlerësohet me kujdes të shtuar. **Edhe kufizimet e justifikuara në parim nga interesa publike mund të prodhojnë shkelje**, nëse ato e vendosin mbrojtjen në pamundësi reale për të kundërshtuar provat e paraqitura nga prokuroria.

72. Gjykata ka konstatuar se aksesit i pakufizuar në dosjen e çështjes dhe përdorimi i pakufizuar i çdo shënimi, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, mundësinë e marrjes së kopjeve të dokumenteve përkatëse, janë garanci të rëndësishme të një gjykimi të drejtë. Mosarritja e një aksesit të tillë ka ndikuar në konstatimin se parimi i barazisë së armëve është

shkelur (*Beraru kundër Rumanisë, 2014, § 70*). Në këtë kontekst, rëndësi i kushtohet pamjes së jashtme, si dhe ndjeshmërisë së shtuar ndaj administrimit të drejtë të drejtësisë. Respektimi i të drejtave të mbrojtjes kërkon që kufizimet në aksesin e një të pandehuri ose avokatit të tij në dosjen gjyqësore nuk duhet të pengojnë që provat t'i vihen në dispozicion të pandehurit para gjyqit dhe që i pandehuri të ketë mundësinë të komentojë mbi to përmes avokatit të tij në parashtrimet me gojë (*Öcalan kundër Turqisë (GC), 2005, § 140*). Megjithatë, në disa raste, një i pandehur mund të pritët të japë arsye specifike për kërkesën e tij për të aksesuar një dokument të caktuar në dosje (*Matanović kundër Kroacisë, 2017, § 177*). **GJEDNJ i kushton rëndësi jo vetëm realitetit material të aksesit, por edhe perceptimit të drejtësisë së procesit:** mungesa e transparencës në qasjen ndaj dosjes dëmton besimin në administrimin e drejtë të drejtësisë. **Kërkesa për arsye specifike nuk mund të shndërrohet në një pengesë disproporcionale,** që në praktikë e zbraz nga përmbajtja e drejta për akses efektiv.

73. Moszbulimi i provave për mbrojtjen mund të shkelë barazinë e armëve, si dhe të drejtën për një seancë dëgjimore kundërshtare (*Kuopila kundër Finlandës, 2000, § 38, ku mbrojtjes nuk iu dha mundësia të komentonte mbi një raport shtesë të policisë*). **GJEDNJ ka theksuar se çdo provë që ka rëndësi për vlerësimin e fajësisë ose pafajësisë duhet, në parim, t'i nënshtrohet debatit kundërshtar,** dhe moszbulimi i saj, edhe kur nuk është vendimtar në mënyrë të izoluar, mund të prishë ekuilibrin procedural të procesit në tërësi. Në tërësinë e tyre, **standardet e konsoliduara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi kohën dhe lehtësirat për përgatitjen e mbrojtjes, ndihmën ligjore praktike dhe efektive, si dhe parimin e barazisë së armëve, imponojnë një vlerësim material dhe jo thjesht formal të drejtësisë së procedurës penale.**

74. Kur i pandehuri, **si pasojë e drejtpërdrejtë e masës së sigurimit “arrest në burg”,** kufizimeve strukturore të paraburgimit, **aksesit të kufizuar ose jo funksional në dosjen gjyqësore,** pamundësisë objektive për studim efektiv të një materiali voluminoz provues dhe **mungesës së komunikimit të plotë, të rregullt dhe konfidencial me mbrojtjen,** gjendet në një pozicion dukshëm më të pafavorshëm se organi i akuzës, **ekuilibri procedural priset në mënyrë thelbësore dhe të pakthyeshme.**

75. Si rrjedhojë e standardeve të mësipërme të GJEDNJ, vlerësimi i gjyqtarës së seancës paraprake lidhur me këtë pretendim të kërkuarit është tërësisht në kundërshtim me të drejtën për t'u njohur me aktet dhe mbrojtur në mënyrë efektive. Më konkretisht, në vendim objekt gjykimi, gjykata ka vlerësuar se: *“Gjykata vlerëson se roli i mbrojtësve të zgjedhur ka qenë gjithashtu aktiv dhe efektiv në drejtim të mbarëvajtjes së interesave të të pandehurit. Ata kanë bërë kërkesa me gojë dhe me shkrim, kundërshtime, parashtrime, si edhe kanë kërkuar në*

mënyrë të vazhdueshme, përfshirë këtu edhe për seancën e fundit, një kopje të procesverbaleve që dokumentojnë debatin gjyqësor në sallë. Justifikimi i përdorur nga ana e tyre se, megjithëse janë njohur me aktet që me datë 24.07.2025 dhe i disponojnë ato, nuk mund t'i printojnë për shkak të sasisë së madhe dhe t'i dërgojnë fizikisht me mjete transporti në ambientet e paraburgimit, mbetet i paargumentuar dhe, si i tillë, i papranueshëm nga Gjykata. Sasia prej rreth 169 fashikujsh, në vlerësimin e Gjykatës, konsiderohet plotësisht e menaxhueshme për t'u dërguar qoftë edhe pjesë-pjesë nga mbrojtësit e të pandehurit në ambientet e paraburgimit. Gjykata konstaton se mundësitë financiare të të pandehurit lejojnë printimin fizik nga mbrojtësit e zgjedhur të kopjeve të skanuara të vëna në dispozicion nga Prokuroria e Posaçme në formë elektronike. Këto kopje të skanuara, duhet theksuar, i janë vënë në dispozicion mbrojtësve të të pandehurit në kohën e përshtatshme dhe pa asnjë shpenzim.”

76. Vlerësimi i gjykatës është tërësisht në kundërshtim me standardet e sipër evidentuara të GJEDNJ, pasi barazon aksesin formal në akte me realizimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes. Fakti që materialet janë vënë në dispozicion në format elektronik nuk përmbush standardin e Nenit 6 § 3 (b) të KEDNJ-së, nëse i pandehuri, për shkak të kushteve objektive të paraburgimit, nuk ka asnjë mundësi reale për t'i aksesuar ato, për t'i studiuar dhe për t'i përdorur në funksion të mbrojtjes së tij. Në këtë kuptim, gjykata shmang analizën materiale të së drejtës për mbrojtje dhe e zëvendëson atë me një konstatim formal, i cili nuk ka asnjë vlerë nëse nuk shoqërohet me kushte konkrete ushtrimi. Më tej, duke argumentuar se mundësitë financiare të të pandehurit lejojnë printimin dhe transportimin e akteve në ambientet e paraburgimit, **gjykata transferon në mënyrë të papranueshme barrën e garantimit të së drejtës për mbrojtje tek vetë i pandehuri dhe mbrojtësit e tij, ndërkohë që kjo përbën një detyrim pozitiv të shtetit dhe jo një përgjegjësi që mund të delegohet.**

77. Po kështu, vlerësimi se një volum prej 169 fashikujsh është “i menaxhueshëm” për t'u dërguar pjesë-pjesë nuk merr në konsideratë realitetin konkret të ushtrimit të mbrojtjes në kushtet e paraburgimit, ku aksesit i fragmentuar në materiale, kufizimet në komunikimin me avokatin dhe pamundësia për të punuar në mënyrë të integruar mbi dosjen e bëjnë praktikisht të pamundur ndërtimin e një strategjie mbrojtëse efektive. Aktiviteti procedural i mbrojtjes, i përmendur nga gjykata, nuk mund të barazohet me efektivitetin e saj, pasi thelbi i së drejtës për mbrojtje qëndron në mundësinë reale për të kundërshtuar provat në substancë dhe jo thjesht në paraqitjen formale të kërkesave. Në këto kushte, krijohet një disbalancë e thellë procedurale ndërmjet palëve, ku organi i akuzës gëzon akses të plotë dhe të menjëhershëm në materialin provues, ndërsa mbrojtja

vendoset në një pozicion dukshëm më të pafavorshëm, në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve. Një kufizim i tillë nuk kalon testin e proporcionalitetit, pasi cenon vetë thelbin e së drejtës për mbrojtje dhe e redukton atë në një garanci thjesht teorike, duke e bërë procesin në dukje kontradiktor, por në substancë të pabarabartë dhe të padrejtë.

78. Gjykata, në arsyetimin e saj, nuk merr në konsideratë faktin se **e drejta për mbrojtje efektive nuk është një e drejtë që realizohet në mënyrë të deleguar, por kërkon pjesëmarrje personale dhe të informuar të të pandehurit në ndërtimin e mbrojtjes së tij.** Edhe nëse pranohet se mbrojtësit kanë pasur akses në materialet e çështjes, **kjo nuk mund të zëvendësojë detyrimin që i pandehuri vetë të ketë mundësi reale për t'u njohur me provat, për t'i kuptuar ato dhe për të dhënë udhëzime konkrete për strategjinë mbrojtëse.** Në kushtet kur materiali provues nuk i është vënë në dispozicion në formë të aksesueshme dhe të përdorshme për të, ndërkohë që ai ndodhet në paraburgim dhe pa mjete teknike për të lexuar materialin elektronik, çdo pretendim për “akses të garantuar” mbetet iluzionar. Kjo situatë cenon jo vetëm nenin 6 § 3 (b), por edhe thelbin e nenit 6 § 3 (c), pasi marrëdhënia funksionale dhe efektive midis të pandehurit dhe mbrojtësit të tij bëhet e pamundur në mungesë të një baze të përbashkët faktike mbi të cilën të ndërtohet mbrojtja. Në këtë kuptim, procesi humbet karakterin e tij si një proces ku i pandehuri “mbron veten me ndihmën e avokatit”, dhe transformohet në një procedurë ku mbrojtja ushtrohet në mënyrë të njëanshme nga avokati, pa mundësinë e ndërveprimit real me klientin. Kjo bie ndesh me konceptin e pjesëmarrjes efektive të të pandehurit në proces dhe e bën mbrojtjen të mangët, duke cenuar drejtësinë e procedurës në tërësi.

79. Një element tjetër thelbësor që gjykata ka anashkaluar lidhet me **burimin dhe autenticitetin e akteve mbi të cilat ndërtohet mbrojtja.** Nuk është detyrë e mbrojtjes të rindërtojë në mënyrë indirekte dosjen përmes materialeve që ka disponuar gjatë fazës së hetimit, pasi këto materiale nuk janë domosdoshmërisht identike me ato që prokuroria ka përzgjedhur dhe administruar në gjykatë bashkë me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Pikërisht në këtë fazë ndodh filtrimi i provave nga ana e organit të akuzës, ku disa akte mund të përjashtohen, apo të paraqiten në një konfigurim të ndryshëm nga ai i hetimit paraprak. Për këtë arsye, **vetëm dosja e depozituar në gjykatë përbën bazën autentike dhe të plotë mbi të cilën duhet të ushtrohet mbrojtja.** Si rrjedhojë, është detyrim i drejtpërdrejtë i gjykatës të sigurojë që kjo dosje t'i vihet në dispozicion të pandehurit në mënyrë të plotë, të aksesueshme dhe funksionale. Çdo referim në akte të mëparshme të njohura gjatë hetimit nuk mund të zëvendësojë këtë detyrim, pasi përndryshe mbrojtja detyrohet të operojë mbi një bazë të pasigurt dhe potencialisht të paplotë, duke rrezikuar seriozisht saktësinë dhe efektivitetin e

kundërshtimit të akuzës. Në këtë kuptim, mungesa e vënies në dispozicion **të dosies gjyqësore** në formën e saj përfundimtare cenon drejtpërdrejt të drejtën për mbrojtje dhe e bën procesin materialisht të pabarabartë.

ii. Në lidhje me cënimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si dhe papajtueshmëria me Kushtetutën e nenit 14 të ligjit nr. 95, datë 6.10.2016

80. Siç evidentuam më sipër, gjatë të gjithë gjykimit, nga ana e z. Veliaj dhe mbrojtjes së tij janë ngritur në mënyrë të vazhdueshme pretendime lidhur me vendosjen në dispozicion të të gjithë akteve dhe provave në ngarkim të z. Veliaj me qëllim që ai personalisht dhe mbrojtja e tij të mund të njihen me to, brenda një periudhe të arsyeshme. Më konkretisht, z. Veliaj ka kërkuar të ketë akses të plotë, të pakufizuar dhe real, si dhe kohën e kushtet e nevojshme për të lexuar aktet, provat dhe çdo deklaram mbi të cilat është ndërtuar akuza në ngarkim të tij dhe që e ka vendosur në izolim atë. Z. Veliaj ka pretenduar gjatë të gjithë procesit se atij personalisht, nuk i është vënë ende në dispozicion një kopje fizike e akteve, si dhe koha minimale për t'u njohur me një akuzë të ndërtuar mbi rreth 62 mijë faqe, duke i bërë praktikisht të pamundur ushtrimin e së drejtës së tij kushtetuese për t'u mbrojtur.

81. Mbrojtësja e caktuar kryesisht nga gjykata deklaroi në seancën e datës 19.01.2026 se deri më datë 18.01.2026 kishte qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, për pasojë, nuk kishte pasur asnjë takim me kërkuesin dhe asnjë mundësi reale për t'u njohur me aktet dhe provat në ngarkim të tij. Pavarësisht kësaj situatë objektive, gjykata vendosi shtyrjen e seancës për datën 02.02.2026, duke supozuar se brenda këtij afati mbrojtësja mund të njihnte dhe përvetësonte një material hetimor më shumë se 60.000 faqesh dhe të realizonte konsultimin përkatës me klientin. Një pritshmëri e tillë është qartazi jorealiste dhe në kundërshtim me çdo standard të mbrojtjes praktike dhe efektive, duke e reduktuar të drejtën për mbrojtje në një formalitet të zbrazët. Nuk mjafton që gjykata të përcaktojë një afat, por afati duhet të jetë realist, i arsyeshëm dhe funksional, duke marrë parasysh: volumin e dosjes, kompleksitetin e çështjes, natyrën e provave, ndikimin e provave në të drejtën e mbrojtjes, kohën reale në dispozicion të të pandehurit. Një proces ku mbrojtja nuk ka kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur, nuk është proces i drejtë, pavarësisht se sa "formalisht" është respektuar procedura. Asnjë akt juridik nuk parashikon që për interesa të "shpejtësisë së procedimit", gjykata mund të kufizojë këtë të drejtë në atë masë sa të bëhet iluzionare. Vendosja e një afati të pamundur për leximin e materialeve përbën një kufizim të së drejtës së mbrojtjes që nuk kalon testin e proporcionalitetit.

82. Në vijim, seanca e datës 2.02.2026 evidentoi në mënyrë të përsëritur dhe të qartë cenime serioze të së drejtës së z. Veliaj për mbrojtje efektive, të cilat, të marra në tërësi, krijojnë bindjen e arsyeshme se procesi nuk po zhvillohet në kushte reale paanësie. Në këtë seancë, vetë avokatja e caktuar nga gjykata deklaroi shprehimisht se nuk kishte pasur asnjë mundësi reale për t'u njohur me dosjen voluminoze dhe aq më tepër për ta konsultuar atë me të pandehurin, duke e bërë objektivisht të pamundur ushtrimin e mbrojtjes efektive. Në këto rrethana, mbrojtësja e caktuar kryesisht kërkoi kohë shtesë për përgatitjen e mbrojtjes, kërkesë kjo e bazuar jo në interesa taktike, por në pamundësinë faktike për të njohur dhe përvetësuar një material hetimor prej më shumë se 60.000 faqesh. Kjo kërkesë u refuzua nga gjykata në mënyrë arbitrare, pa një arsytim ligjor bindës dhe pa marrë parasysh se bëhej fjalë për një mbrojtëse të emëruar nga vetë gjykata. Më tej, refuzimi u shoqërua me komente dhe batuta denigruese ndaj aktivitetit profesional privat të mbrojtëses, çka përbën një sjellje të papërshtatshme gjyqësore dhe cenon rëndë dinjitetin e funksionit mbrojtës në procesin penal, të cili gjykata nuk e shmangu.

83. Në mënyrë paradoksale, gjykata e konsideroi mbrojtjen të “ezauruar”, në një situatë ku as avokatja e caktuar nga gjykata dhe as vetë z. Veliaj nuk kishin pasur akses real në dosje. Ky vlerësim formal bie në kundërshtim flagrant me parimin e mbrojtjes praktike dhe efektive, pasi një mbrojtje që nuk mund të ushtrohet për shkak të mungesës së njohjes së akteve dhe provave nuk mund të konsiderohet kurrsesi e realizuar. Kur iu dha fjala, z. Veliaj u shpreh qartë se dëshironte të ushtronte të drejtën e tij për mbrojtje dhe theksoi se kishte qenë i pranishëm në seancë edhe në kushte jo të mira shëndetësore, pikërisht për këtë qëllim. Ai ngriti çështjen thelbësore se si mund të realizohej mbrojtja në mungesë të njohjes së dosjes, duke vënë në dukje se këtë mundësi nuk e kishte pasur as mbrojtësja e caktuar nga vetë gjykata. Këto shpjegime, ndonëse thelbësore për vlerësimin e procesit të rregullt, u injoruan plotësisht nga gjykata. Edhe propozimet minimale dhe proporcionale për korrigjimin e kësaj shkeljeje, si mundësia që z. Veliaj të njihej me aktet përmes një pajisjeje elektronike, u refuzuan pa asnjë analizë serioze. Ky qëndrim dëshmon mungesën e vullnetit të gjykatës për të garantuar kushte reale për ushtrimin e mbrojtjes dhe për të rikthyer ekuilibrin procedural midis palëve.

84. Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, fusha e zbatimit të nenit 6 § 3 (a) duhet të vlerësohet në dritën e të drejtës më të gjerë për një gjykim të drejtë, të garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës. Në çështjet penale, dhënia e informacionit të plotë dhe të detajuar mbi akuzat ndaj një të pandehuri, dhe, rrjedhimisht, mbi kualifikimin juridik që gjykata mund t'u japë

fakteve të çështjes, është një parakusht thelbësor për të siguruar që procedimi të jetë i drejtë.¹ Nënparagrafët (a) dhe (b) të nenit 6 § 3 lidhen me njëra-tjetrën, pasi e drejta për t'u informuar mbi natyrën dhe shkakun e akuzës duhet vlerësuar në dritën e së drejtës së të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen.²

85. Neni 6 § 3 (a) i KEDNJ nënvizon nevojën që t'i kushtohet vëmendje e veçantë njoftimit të “akuzës” ndaj të pandehurit. Të dhënat konkrete mbi veprën penale luajnë një rol vendimtar në procesin penal, pasi nga momenti i njoftimit të tyre i dyshuari vihet formalisht në dijeni me shkrim për bazën faktike dhe juridike të akuzave që ngrihen kundër tij.³ Neni 6 § 3 (a) i garanton të pandehurit të drejtën të informohet jo vetëm për “shkakun” e akuzës, domethënë aktet që pretendohet se ai ka kryer dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe për “natyrën” e akuzës, pra kualifikimin juridik që u jepet këtyre akteve.⁴ Neni 6 § 3 (b) ka gjithashtu rëndësi për të drejtën e të akuzuarit për akses në dosje dhe për marrjen e provave të zbuluara nga autoritetet, dhe në këtë kuptim ai mbivendoset me parimet e barazisë së armëve dhe të procesit kontradiktor të parashikuara nga neni 6 § 1.⁵ Në rastin konkret, pavarësisht kërkesave të tij drejtuar gjyqtarës së çështjes, kërkuesit nuk i janë vendosur në dispozicion aktet dhe provat në ngarkim të tij, mbi të cilat bazohet akuza, duke mos pasur në këtë mënyrë “informacion të plotë dhe të detajuar”, lidhur me akuzën në ngarkim, pjesë e së cilës janë edhe provat mbi të cilat ajo bazohet sepse në të kundërt i bie të pranojmë që merren të mirëqena pretendimet e Prokurorisë, pa qenë nevoja që i pandehuri të mund ti shqyrtojë vetë provat në ngarkim të tij, në shkelje kjo edhe të barazisë së palëve dhe kontradiktoralitetit në gjykim.

86. Ndërsa Prokuroria ka pasur në dispozicion të gjithë mekanizmin institucional për të mbledhur, administruar, strukturuar dhe analizuar provat, duke pasur akses të plotë, të pakufizuar dhe në kushte optimale pune, z. Veliaj, i izoluar në një ambient paraburgimi, nuk ka marrë asnjë kopje të materialeve në një format praktikisht të përdorshëm, që të mundësonte ushtrimin e real të së drejtës së tij për tu njohur me aktet dhe provat në ngarkim, si dhe për t'u mbrojtur. Kjo mospërputhje e skajshme midis pozitës procedurale të palëve përbën një cenim të drejtpërdrejtë të barazisë së armëve, e cila për nga natyra e saj është një komponent themelor i nenit 6 të KEDNJ-së. Barazia e armëve nuk kërkon trajtim identik, por kërkon që secila palë të ketë mundësi reale dhe efektive për të paraqitur çështjen e vet në kushte që nuk e vënë atë në disavantazh të dukshëm. Në këtë rast, diferenca midis mundësisë së Prokurorisë për të

¹ Sejdovic v. Italy (GC), 2006, § 90; Varela Geis v. Spain, 2013, § 42.

² Dallos v. Hungary, 2001, § 47; Pélissier and Sassi v. France (GC), 1999, § 54.

³ Pélissier and Sassi v. France (GC), 1999, § 51; Kamasinski v. Austria, 1989, § 79.

⁴ Mattoccia v. Italy, 2000, § 59; Penev v. Bulgaria, 2010, §§ 33 and 42.

⁵ Rowe and Davis v. the United Kingdom (GC), 2000, § 59; Leas v. Estonia, 2012, § 76.

ndërtuar akuzën dhe mundësisë së të pandehurit për t'u mbrojtur është aq ekstreme, sa e cenon standardin minimal të nenit 6 të KEDNJ. Kjo është një nga treguesit kryesorë objektivë të mungesës së paanshmërisë së gjyqtares.

87. Sa më sipër evidentuam standardet e GJEDNJ lidhur me të drejtën për tu njohur me aktet dhe mbrojtur në mënyrë efektive, nënvizojnë ekzistencën e një detyrimi pozitiv të gjykatës, që shkon përtej rolit pasiv arbitral: **kur është e dukshme se mbrojtja nuk ka pasur kohë reale dhe të mjaftueshme, gjykata duhet të ndërhyjë ex officio. Mosushtrimi i kësaj kompetence në rrethana të tilla cenon thelbin e nenit 6 § 3 (b) dhe ndikon drejtpërdrejt në drejtësinë e procedurës. GJEDNJ ka bërë të qartë se, kur shteti zgjedh të mbajë një person në paraburgim, ai merr mbi vete përgjegjësinë për të garantuar që këto kushte të mos dëmtojnë kapacitetin e tij intelektual dhe fizik për të marrë pjesë në mbrojtje.** (*Razvozhayev kundër Rusisë dhe Ukrainës dhe Udaltsov kundër Rusisë, 2019, § 252*) Në rastin konkret këto standarde janë shkelur haptazi nga gjyqtarja e çështjes.

88. Në të njëjtën linjë, gjykata, në seancën e datës 1.02.2026, në të cilën u gjykua kërkesa e z. Veliaj për ndryshimin e masës së sigurisë, pranoi pa rezerva argumente të ngritura nga prokuroria, sipas të cilave ushtrimi i së drejtës për mbrojtje u paraqit si rrethanë rënduese, duke u lidhur në mënyrë keqdashëse me pretendime për “lobim” jashtë vendit. Këto pretendime, të pambështetura në prova ligjore, u shoqëruan me paraqitjen në gjykatë të materialeve joprocedurale, si portale mediatike dhe opinione gazetarie, të cilat u trajtuan në mënyrë të papranueshme si elemente provuese. Pranimi i këtyre materialeve dhe përdorimi i tyre për të justifikuar vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg” përbën një devijim serioz nga standardet e provës në procesin penal dhe krijon perceptimin e një qëndrimi haptazi favorizues ndaj prokurorisë. Në këtë mënyrë, gjykata jo vetëm që nuk ka korrigjuar shkeljet e së drejtës së mbrojtjes, por i ka legjitimuar ato përmes vendimmarrjeve të saj.

89. Sjellja e gjyqtares gjatë gjithë seancës, refuzimi sistematik i kërkesave minimale të mbrojtjes dhe pranimi i pakushtëzuar i qëndrimeve të prokurorisë krijojnë objektivisht bindjen se gjykata nuk po qëndron në pozicion neutral, por është shndërruar në një palë në proces. Këto rrethana, të vlerësuara në dritën e testit objektiv të paanshmërisë, janë të mjaftueshme për të krijuar një dyshim të arsyeshëm dhe të përligjur mbi mungesën e paanshmërisë së gjyqtares, në kuptim të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, disavantazhi në të cilin Gjykata e ka vendosur z. Veliaj nuk është thjesht “i dukshëm”, por ekstrem, i pakapërcyeshëm dhe material: Prokuroria ka ndërtuar akuzën mbi një volum prej rreth 60.000 faqesh, të cilat i ka mbledhur vetë dhe pasur në dispozicion për muaj të tërë; ndërsa z. Veliaj, për shkak të mosdhënies së dosjes në format të lexueshëm dhe praktik, si dhe për shkak të afatit krejtësisht

jo-realist, është vendosur në një pozitë ku mbrojtja bëhet iluzore, jo faktikisht e ushtrueshme. Një e drejtë që nuk mund të ushtrohet, është një e drejtë e mohuar.

90. Në këtë këndvështrim, nga Gjyqtarja e çështjes, jo vetëm që është shkelur standardi i barazisë së armëve, por edhe ai i kontradiktorialitetit të gjykimit, pasi z. Veliaj nuk ka pasur asnjë mundësi reale të njihet me provat mbi të cilat Prokuroria mbështet akuzën. Kjo disbalancë e krijuar dhe e toleruar nga gjyqtarja e çështjes është një tregues i fuqishëm objektiv i mungesës së paanshmërisë, në kuptimin e testit objektiv të GJEDNJ-së, sipas të cilit pyetja kyçe është: *“A ka një vëzhgues i paanshëm arsye të arsyeshme të dyshojë se gjykata nuk po qëndron neutrale?”*.⁶ Vendimmarrja e gjyqtares për të vazhduar procesin në kushte të tilla ku njëra palë ka njohuri të plota mbi dosjen, ndërsa pala tjetër nuk mund të lexojë as materialet minimale mbi të cilat akuzohet, krijon pikërisht dyshimin e arsyeshëm që gjykimi nuk po zhvillohet në kushte të balancuara dhe të ndershme. Për këtë arsye, ky tregues është i mjaftueshëm për të konstatuar ekzistencën e shkaqeve “të rëndësishme të njëanshmërisë” në kuptimin e nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale.

91. Pra, nga rrethanat konkrete të zhvillimit të çështjes, arrijmë në konkluzionin që në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, përmes sjelljes së saj në proces, gjyqtarja e çështjes, ka shfaqur arsye serioze njëanshmërie dhe paragjykimimi të çështjes, duke cënuar standardin normal të zhvillimit të një procesi të rregullt gjyqësor në një sallë gjyqësi dhe të drejtën e palës paditëse për tu njohur përmes Gjykatës me të gjitha aktet dhe provat në ngarkim të tij, brenda një afati të arsyeshëm, si një e drejtë që i mundëson palës në proces barazinë e armëve në procesin e kontradiktorialitetit në seancë gjyqësore. Në mbështetje të argumenteve të mësipërme, vlen të citojmë edhe përmbajtjen e vendimit nr.16/2003, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin theksohet rëndësia e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit, ku GJK shprehet:

*“parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet **dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim**. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e*

⁶ Kyprianou v. Cyprus (GC), 2005, § 118; Micallef v. Malta (GC), 2009, § 93).

drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë.”

92. Ndërkohë, në vendimin nr. 11, datë 5.04.2013, Gjykata Kushtetuese shprehet:

“Në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit tek gjyqësori me qëllim që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që po bëhet. Janë këto arsye, të cilat kanë çuar në ngritjen në nivel kushtetues të parimit të paanshmërisë së gjyqtarit, i cili rrjedh nga parimi i lashtë latin nemo iudex in causa sua. Ky parim është mbështetur pikërisht në ekzistencën e premisë që gjyqtari të mos vendoset në pozitë të tillë, ku vendimmarrja e tij të jetë e dyshimtë për shkak të pamundësisë për të reflektuar paanësinë dhe që çon në krijimin e dyshimit ose bindjes te palët se këto nuk po dëgjohen siç duhet nga gjykata.

93. Ndërsa, në vendimin nr. 23/2008, Gjykata Kushtetuese shprehet:

“... në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë se roli i tij gjatë gjykimit duhet të jetë pasiv dhe super partes “.

94. Gjithashtu në vendimin nr. 23, datë 04.11.2008, nr. 25, datë 11.06.2013 dhe nr. 6, datë 16.02.2015, Gjykata Kushtetuese, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi paanshmërisë së gjyqtarit, shprehet:

“duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie.”

95. Ndërkohë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Harabin v. Sllovakia, § 136 ka theksuar që:

"dukja" ka një rëndësi të caktuar, kjo sepse me fjalë të tjera, "drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por gjithashtu duhet të shihet se bëhet". Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik. Kështu, çdo gjyqtar në lidhje me të cilin ekziston një arsye e ligjshme për të pasur frikë nga mungesa e paanësisë duhet të tërhiqet nga gjykimi i çështjes (Micallef v. Malta (GC), § 98). Një gjykatë që shqyrton një kërkesë për përjashtimin/heqjen dorë të gjyqtarit, duhet të adresojë argumentet e paraqitura në mbështetje të kërkesës"

96. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të theksohet se kërkesa për përjashtim nuk ka natyrën e një "sanksioni personal" ndaj gjyqtarës së çështjes, por është një garanci objektive procedurale për mbrojtjen e besimit në procesin gjyqësor dhe për sigurimin e standardeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ. Në të drejtën kushtetuese dhe konventore nuk kërkohet që të provohet njëanshmëria subjektive e gjyqtarit; mjafton që, në dritën e rrethanave të çështjes, të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm dhe i përligjur nga ana e të pandehurit se gjykimi nuk po zhvillohet në kushte reale paanësie. Pikërisht ky standard, vendos fokusin tek "dukja e jashtme" e paanësisë dhe tek perceptimi i palëve dhe i publikut, jo vetëm tek bindja e brendshme e gjyqtarit.

97. Në rastin konkret, shkeljet e përsëritura të së drejtës së mbrojtjes (mosdhënia në dispozicion e akteve në format të përdorshëm, caktimi i një afati krejtësisht jorealit për 60.000 faqe, mosgarantimi efektiv as i këtij afati minimal) krijojnë një situatë ku gjyqtarja jo vetëm nuk ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm për njëanshmëri, por përkundrazi, ka ndërtuar në mënyrë objektive bindjen te z. Veliaj se gjykata nuk po qëndron neutrale. Këtu nuk kemi të bëjmë me një pakënaqësi subjektive të palës, por me një seri vendimesh procedurale të vetë gjyqtarës së çështjes, të cilat, të marra së bashku, e vendosin z. Veliaj në një pozitë të qartë inferiore, në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve, duke e bërë gjykimin të duket, dhe të jetë, i padrejtë.

98. Më tej, nuk mund të neglizhohet fakti se e njëjta gjyqtare që ka marrë vendimet kufizuese ndaj së drejtës së mbrojtjes së z. Veliaj, ka vijuar gjykimin e çështjes pa korrigjuar asnjë prej këtyre shkeljeve. Kjo krijon një konflikt të qartë në raport me parimin *nemo iudex in causa sua*: gjyqtarja nuk mund të jetë, në të njëjtën kohë, autorja e vendimeve që kanë cenuar të drejtën e mbrojtjes dhe gjyqtarja që duhet të garantojë një proces të drejtë. Çdo vendim i mëtejshëm mbi vazhdimin e procesit, marrë nga e njëjta gjyqtare, perceptohet në mënyrë të pashmangshme si një auto-legjitimim i sjelljes së saj të mëparshme, dhe jo si një vlerësim i

paanshëm mbi ligjshmërinë dhe drejtësinë e procedimit. Kjo bie drejtpërdrejt ndesh me standardin kushtetues dhe konventor që kërkon jo vetëm që drejtësia të bëhet, por të shihet qartë nga i pandehuri dhe nga publiku se ajo po bëhet në mënyrë të paanshme.

99. Në rastin konkret, gjyqtarja e çështjes znj. Etleva Deda dukshëm nuk e ka reflektuar paanësinë e tij dhe ka krijuar përmes shkeljeve flagrante ligjore bindjen te z. Veliaj që çështja e tij nuk po dëgjohet dhe nuk ka për tu dëgjuar siç duhet nga Gjykata.

100. Gjithashtu, Gjyqtarja e seancës paraprake, nuk mund të konsiderohet as e pavarur dhe as e paanshme ndaj Prokurorisë së Posaçme, për shkak të **një raporti të qartë varësie institucionale që buron nga vetë kuadri ligjor në fuqi.** Në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 95, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Prokuroria e Posaçme ushtron kompetencën për hetimin penal të gjyqtarëve të posaçëm, përfshirë edhe gjyqtaren që shqyrton kërkesën e saj në fazën e seancës paraprake. Kjo do të thotë se **pala që paraqet akuzën dhe kërkon kalimin e çështjes për gjykim është njëkohësisht organi që ka autoritetin ligjor për të ushtruar ndjekje penale ndaj gjyqtarës që duhet të vendosë mbi këtë kërkesë.** Një dispozitë e tillë, e cila siç do të argumentojmë në vijim është në kundërshtim me Kushtetutën, cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë pavarësinë funksionale të gjyqtarit, pasi krijon një lidhje të papranueshme ndërmjet ushtrimit të funksionit gjyqësor dhe ekspozimit ndaj një autoriteti hetimor që është palë në proces. Pavarësia e gjyqtarit nuk nënkupton vetëm mungesën e ndërhyrjes konkrete, por edhe ekzistencën e një statusi institucional që e vendos atë përtej çdo forme ndikimi apo presioni të mundshëm nga palët. Kur njëra prej këtyre palëve gëzon kompetencën për të hetuar penalisht gjyqtarin, kjo garanci rrënohet në themel, pasi krijohet një presion objektiv dhe i vazhdueshëm që prek lirinë e brendshme të gjyqimit.

101. Paralelisht, cenimi i pavarësisë prodhon në mënyrë të pashmangshme edhe cenimin e paanësisë. Gjyqtarja vendos mbi kërkesat e një pale që, në çdo moment, mund të ushtrojë ndaj saj kompetenca hetimore penale, çka krijon një disbalancë të dukshme në raportin ndërmjet palëve dhe gjykatës. Në këtë kontekst, paanësia nuk vihet në dyshim vetëm në planin subjektiv, por mbi të gjitha në planin objektiv: një vëzhgues i arsyeshëm dhe i paanshëm do të kishte dyshime serioze nëse gjyqtarja mund të vendosë në mënyrë të lirë dhe të pavarur ndaj një organi që ka pushtet të drejtpërdrejtë mbi të në aspektin penal. Kjo situatë përbën një defekt strukturor të vetë modelit të organizimit të procesit, i cili bie ndesh me parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kompetenca e Prokurorisë së Posaçme për të hetuar gjyqtarët nuk gjen mbështetje në Kushtetutë dhe përfaqëson një zgjerim të pajustificuar të rolit të saj, duke e shndërruar atë nga palë procedurale në një autoritet me

ndikim potencial mbi vetë trupën gjyqësore që e gjykon. Në këto kushte, mungesa e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarës është tashmë një realitet i diktuar nga vetë kuadri ligjor. Si rrjedhojë, vendimmarrja e saj në këtë fazë procedurale mbart një cenim themelor, pasi është marrë në kushtet e një raporti të papajtueshëm me standardet minimale të një gjykate të pavarur dhe të paanshme, duke e bërë procesin të komprometuar që në origjinë.

102. Kompetencat e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe ato të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë përcaktuar në një sërë dispozitash kushtetuese. Këto organe të posaçme kanë kompetencë për ndjekjen penale, hetimin dhe gjykimin e funksionarëve të lartë, të cilët bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias janë listuar në mënyrë eksplicite dhe shteruese në Kushtetutë (kompetencë për shkak të funksionit të subjektit), si dhe hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e subjekteve të dyshuar si të përfshirë në kryerjen e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar (kompetencë për shkak të llojit të veprës penale). Bazuar në parashikimet kushtetuese në fuqi, vetëm drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe kryetarët e gjykatave të posaçme, të cilët janë drejtues të institucioneve të pavarura kushtetuese, duhet të ndiqen penalisht, hetohen dhe gjykohen nga organet e posaçme.

103. Me miratimin e ligjit nr. 95, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, një prej ligjeve pjesë e “paketës së ligjeve të reformës në drejtësi”, **pa pasur një autorizim kushtetues dhe madje në kundërshtim me formulimet kushtetuese në fuqi, përmes nenit 14 legjislatori shtoi një kompetencë të re për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme**, ajo e hetimit dhe ndjekjes penale të prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm. Kompetenca për gjykimin e këtyre funksionarëve, nuk ju është dhënë gjykatave të posaçme nga asnjë dispozitë kushtetuese ose ligjore. Si rrjedhojë, aktualisht gjendemi përpara një dispozite ligjore e cila paraqet një sërë problematikash kushtetuese, të tilla si cënimi i parimit të hierarkisë së burimeve të së drejtës, parimit të kushtetutshmërisë, parimit të pavarësisë, parimit të procesit të rregullt, etj.

104. Në një prej dokumenteve që i parapriu hartimit dhe miratimit të reformës së drejtësisë në vendin tonë, “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, i hartuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, në qershor të vitit 2015, evidentohet rëndësia e përcaktimit në Kushtetutë të krijimit të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (në vijim: gjykatat e posaçme), për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nivelit të ulët profesional të tyre, mungesës së mekanizmave efikas të kontrollit mbi ta, si dhe politizimit të tyre për shkak të gjykimin të çështjeve me ndikim politik. Përpjekjet e herëpashershme të qeverive të ndryshme

për t'i adresuar këto probleme vlerësohej se kishin dështuar, sepse ndërhyrjet e propozuara ligjore kishin qenë të pjesshme dhe në asnjë rast nuk kishin prekur rregullimet përkatëse kushtetuese. Nisur nga këto gjetje, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë u shpreh pa ekuivok se gjendja në të cilën ndodhej sistemi i drejtësisë në Shqipëri diktonte nevojën e ndryshimeve thelbësore kushtetuese, sepse Kushtetutës në fuqi i mungonin disa mekanizma dhe procedura thelbësore, të cilat do të bënin të mundur garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë.⁷

105. Në këtë kuadër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, përmes amendimeve të bëra me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, në paragrafin e dytë të nenit 135 të saj parashikoi kompetencat e gjykatave të posaçme, duke përcaktuar **(1)** në mënyrë eksplicite rrethin e funksionarëve të lartë akuzat penale kundër të cilëve gjykohen nga këto gjykata, pavarësisht llojit të veprës penale që ata kanë kryer, edhe nëse këta zyrtarë nuk janë më në këtë funksion, por vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës, duke mos bërë thjesht një parashikim të përgjithshëm “funksionarë të lartë”, por duke i listuar këta zyrtarë në mënyrë nominative, si dhe **(2)** llojin e veprave penale të cilat janë pjesë e kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më konkretisht “veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar”. Ndryshe nga qasja që mbajti në rastin e përcaktimit të kompetencës së këtyre gjykatave për shkak të funksionit të lartë që kanë funksionarët, duke i përcaktuar vetë në mënyrë shteruese në tekstin e saj se cilët janë këta “funksionarë të lartë”, në rastin e llojit të veprave penale të cilat janë pjesë e kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme, kushtetutë bërësi nuk i listoi në mënyrë shteruese, por e la këtë në diskrecion të legjislatorit (rezervë ligjore absolute).

106. Në draftin e parë që iu dërgua Komisionit të Venecias për opinion paraprak në tetor të vitit 2015, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë propozoi që gjykatat e posaçme të gjykonin akuzat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar kundër “funksionarëve të lartë”, pa përcaktuar në Kushtetutë në mënyrë eksplicite dhe shteruese se cilët do të quheshin “funksionarë të lartë”. Por Komisioni i Venecias vlerësoi se ishte e nevojshme të jepej në Kushtetutë (dhe jo të bëhej me ligj) një përkufizim i termit “funksionar i lartë”, me qëllim identifikimin e qartë të subjekteve, ndërsa rregullimet e detajuara mund të gjenin pasqyrim në legjislationin zbatues.⁸ Si rrjedhojë, për të pasqyruar këtë opinion të Komisionit të Venecias,

⁷ Për më tepër shih: “Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, i hartuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, në qershor të vitit 2015, si dhe Komentarin mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë (2016), i hartuar në vitin 2019.

⁸ Për më tepër shih Opinionin final të Komisionit të Venecias, datë 12 mars 2016 § 50.

paragrafi i dytë i nenit 135 të Kushtetutës parashikon në mënyrë eksplicite dhe shteruese rrethin e zyrtarëve të lartë, akuzat penale ndaj të cilëve gjykohen nga gjykatat e posaçme:

Neni 135

2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

107. Në vijim të këtij parashikimi, përmes paragrafit të katërt të nenit 148 të Kushtetutës, si dhe paragrafit të parë të nenit 148/dh të po këtij akti, kushtetutë bërësi ka përcaktuar edhe kompetencën e Prokurorisë së Posaçme dhe Njesisë së Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale e cila është e njëjtë me rrethin e çështjeve që janë brenda kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme, me përjashtimin e vetëm që gjykatat e posaçme të njëjtat çështje i gjykojnë, ndërsa Prokuroria e Posaçme kryen ndjekjen penale dhe hetimin e tyre:

Neni 148

4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 148/dh

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë.

108. Siç evidentuam më sipër, ndryshe nga qasja që ka pasur në rastin e përcaktimit të kompetencës së kësaj gjykate për shkak të funksionit që kanë zyrtarët e lartë (duke i përcaktuar në mënyrë eksplicite, shteruese në Kushtetutë se cilët zyrtarë të lartë janë brenda kompetencës së gjykimit të Gjykatës së Posaçme dhe si rrjedhojë edhe në kompetencën e hetimit dhe ndjekjes penale të Prokurorisë së Posaçme), kompetencën lëndore të këtyre dy organeve të posaçme lidhur me kategorinë e veprave penale që do të përfshihen në nocion kushtetues “veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar”, kushtetutë bërësi ja la në diskrecion legjislatorit ta përcaktonte. Për të pasqyruar këtë rezervë ligjore absolute, në Kodin e Procedurës Penale, përmes ligjit nr. 35/2017, datë 30.03.2017, të ndryshuar, u specifikuan në nenin 75/a, llojet e “veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar”, duke u lënë e paprekur kompetenca për shkak të funksionit që kanë zyrtarët e lartë, e specifikuar në mënyrë shteruese në Kushtetutë. Më konkretisht, në nenet 75/a dhe 25 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet:

Neni 75/a

Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës , Kryetarit të Kuvendit , Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë , Prokurorit të Përgjithshëm , Inspektorit të Lartë të Drejtësisë , kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 25

Ushtrimi i funksioneve të prokurorit

1. Funksionet e prokurorit ushtrohen:

a) në hetimet paraprake dhe në gjykimet e shkallës së parë, nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë;

b) në gjykimet e çështjeve të ankimuar, nga prokurorët pranë gjykatave të apelit dhe pranë Gjykatës së Lartë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij prokurori është i pavarur. Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj.

3. Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

109. Por, pavarësisht se **(1)** në Kushtetutë u parashikua në mënyrë shteruese rrethi i funksionarëve të lartë, akuzat penale ndaj të cilëve hetohen dhe ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme dhe gjykohen nga gjykatat e posaçme, si dhe **(2)** përmes dispozitave kushtetuese nuk u autorizua ligjvënësi për të shtuar me ligj rrethin e këtyre funksionarëve, përmes ligjit nr. 95, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (në vijim ligji nr. 95/2016), më konkretisht **nenit 14 të tij (i cili për më tepër mbart një titull i cili nuk përputhet shumë për nga kuptimi për me përmbajtjen e tij)**, legjislatori parashikoi një kompetencë të re për prokurorët e Prokurorisë së Posaçme. Më konkretisht, ligjvënësi shtoi rrethin e “funksionarëve të lartë” të cilët për shkak të funksionit të tyre janë brenda kompetencave të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, por çuditërisht nuk janë brenda kompetencave të gjykatave të posaçme. Neni 14 i këtij ligji, me titull “përgjegjshmëria” parashikon se kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kanë kompetencë të hetojnë dhe të ndjekin penalisht prokurorë ose gjyqtarë të posaçëm. Më konkretisht:

Neni 14

Përgjegjshmëria

Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, kur kanë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale, hetojnë dhe ndjekin penalisht prokurorë të

Prokurorisë së Posaçme ose gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

110. E NJËJTA KOMPETENCË, POR KËSAJ RADHE LIDHUR ME GJYKIMIN E PROKURORËVE OSE GJYQTARËVE TË POSAÇËM NUK JU NJOH GJYQTARËVE TË POSAÇËM NË ASNJË DISPOZITË TË LIGJIT NR. 95/2016 DHE NUK I NJIHET PËRMES ASNJË DISPOZITE TJETËR LIGJORE NË FUQI.

Kompetenca lëndore parësore e Prokurorisë dhe gjykatave të Posaçme, e përcaktuar në paragraf 1 të nenit 135; paragraf 4 të nenit 148; paragraf 1 të nenit 148/dh të Kushtetutës; si dhe të detajuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale plotësohet edhe me ndryshimin e nenit 80 të po këtij Kodi në të cilin ligjvënësi ka rregulluar kompetencën dytësore të kësaj gjykate në rastet e procedimeve të lidhura. Pra, në të gjitha rastet kur ndodhemi përpara procedimeve të lidhura ndërmjet tyre, të cilat janë pjesërisht në kompetencë të gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe pjesërisht në kompetencë të gjykatave të zakonshme dhe procedimet nuk mund të ndahen, çështja do të shqyrtohet nga gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila merr përparësi nga pikëpamja e kompetencës lëndore, më konkretisht:

Neni 80

Bashkimi i procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme

Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë kompetencë e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe procedimet e tjera në kompetencë të gjykatave të tjera të shkallës së parë, kompetente është Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ky rregull zbatohet edhe në rastin e të pandehurve të mitur. Në këtë rast, gjykata zbaton rregullat e gjyqimit për të miturit.

111. Edhe në paragrafin e parë të nenit 9 të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, me titull “Kompetenca lëndore të tjera”, evidentohet një parashikim i ngjashëm me sa më sipër. Megjithatë, ndryshe nga parashikimi i mësipërm i Kodit të Procedurës Penale, në këtë parashikim ligjor nuk evidentohet kriteri që procedimi që nuk është brenda kompetencave të Gjykatës së Posaçme, për t’u shqyrtuar nga kjo e fundit dhe hetuar nga Prokuroria e Posaçme, përveçse duhet të jetë i lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale që është brenda

kompetencave të këtyre organeve të posaçme, duhet që edhe të jetë i pandashëm nga ky procedim penal:

Neni 9

Kompetenca lëndore të tjera

Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

112. Lidhur me kompetencën dytësore të Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme për shkak të lidhjes së procedimeve, Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, në procesverbalin e datës 6.07.2016, eksperti i nivelit të lartë z. JohnSmibert shprehet:

Pyetja e dytë që ju bëtë kishte të bënte me kompetencat parësore dhe dytësore dhe në mënyrë specifike ju përqendroheshit te zyrtarët e lartë, edhe pse kjo nuk do të ishte mirë në këtë mënyrë. Nëse do të shihni në nenin 75.a, aty përfshihen të gjithë veprat penale që kryhen nga personat dhe aty specifikohen të gjitha krimet. Pra, neni 75 përfshin edhe çfarëdolloj vepre penale që kryhet nga persona të veçantë. Për sa u takon kompetencave dytësore, kjo nuk do të thotë që unë mund të sjell një çështje si një prokuror i veçantë brenda zyrës së prokurorisë të posaçme vetëm duke u bazuar në kompetencën dytësore, ti duhet të kesh kompetencën parësore. Pra, duhet të jetë një çështje korrupsioni dhe mbase kjo çështje korrupsioni ka brenda saj edhe pastrimin e parave apo ka edhe diçka që lidhet edhe me dëshmitarin dhe ky ishte qëllimi i kësaj.

113. **Bazuar në parashikimet e mësipërme kushtetuese, Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat e posaçme nuk kanë kompetencë për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm për shkak të funksionit që ata kanë. Këto organe të posaçme kanë kompetencë kushtetuese për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e personave të cilët janë në pozicionin e prokurorit të posaçëm ose gjyqtarit të posaçëm, jo për shkak të funksionit të këtyre të fundit si prokurorë ose gjyqtarë të posaçëm, por vetëm nëse këta të fundit akuzohen për veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, të cilat në mënyrë shteruese janë të listuara më pas në nenin 75/a, paragrafët “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale. E njëjta gjë si me kompetencën kushtetuese**

të këtyre organeve lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të zakonshëm.

114. Sipas parashikimeve kushtetuese në fuqi, vetëm drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe kryetarët e gjykatave të posaçme, të cilët për shkak se janë drejtues të institucioneve të pavarura kushtetuese, ndjekja penale, hetimi dhe gjykimi i tyre hyjnë në kompetencat kushtetuese të organeve të posaçme. Pavarësisht se në Kushtetutë u parashikua në mënyrë eksplicite dhe shteruese rrethi i funksionarëve të lartë, akuzat penale ndaj të cilëve hetohen dhe ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme dhe gjykohen nga gjykatat e posaçme, si dhe përmes dispozitave kushtetuese nuk u autorizua ligjvënësi për të shtuar me ligj rrethin e këtyre funksionarëve, përmes nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, ligjvënësi shtoi rrethin e “funksionarëve të lartë” të cilët janë brenda kompetencave të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, por çuditërisht nuk janë brenda kompetencave të gjykatave të posaçme. Kjo sepse përmes nenit 14 të ligjit nr. 95/2016, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme ju njoh kompetenca për hetimin dhe ndjekjen penale të tyre për shkak të funksionit, pavarësisht llojit të veprës penale për të cilën mund të akuzohen, por kompetenca për gjykimin e prokurorëve ose gjyqtarëve të posaçëm nuk ju njoh gjykatave të posaçme në asnjë dispozitë të ligjit nr. 95/2016 dhe nuk ju njihet gjykatave të posaçme përmes ndonjë dispozite tjetër ligjore në fuqi. Në këtë kuadër, neni 14 i ligjit nr. 95/2016 paraqet një sërë problematikash me natyrë kushtetuese.

115. Në radhë të parë, neni 14 i ligjit nr.95/2016, që zgjeron kompetencat kushtetuese të Prokurorisë së Posaçme nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por në tejkalime jashtëkushtetuese, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, si rrjedhojë kjo ka prekur parimin e hierarkisë së normave dhe ka pasqyruar ndryshime në kompetencat kushtetuese të Prokurorisë së Posaçme. Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim të autorizojë ligjvënësin të zgjerojë rrethin e “funksionarëve të lartë” të cilët janë pjesë e kompetencave të hetimit dhe ndjekjes penale të Prokurorisë së Posaçme dhe as nuk e ka bërë një gjë të tillë. Madje nuk kishte as se si ta bënte në këtë mënyrë sepse s’mund të autorizonte ligjvënësin që vetëm të zgjeronte kompetencat e Prokurorisë së Posaçme në këtë drejtim, pa autorizuar zgjerimin edhe të kompetencave të gjykatave të posaçme. Sepse nuk ka asnjë logjikë juridike që nga njëra anë të autorizohet ligjvënësi të zgjerojë kompetencat e Prokurorisë së Posaçme, por më pas akuzën e Prokurorisë së Posaçme ta gjykojnë gjykatat e zakonshme, të cilat nuk kanë të njëjtat garanci ligjore me organet e posaçme të krijuara në kuadër të reformës në drejtësi, kjo çënon edhe shtetin e të drejtës, në komponentin e sigurisë juridike.

116. Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore nga partitë politike ose qeveria. Por, Kushtetuta, përveç kësaj mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet për të cilat nuk mund t'i lërë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm. (Vendimi nr. 16 datë 10.04.2015 i Gjykatës Kushtetuese) Gjykata Kushtetuese ka theksuar se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. (Vendimi nr.3, datë 20.02.2006 i Gjykatës Kushtetuese) Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës dhe është një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese në çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar se “atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla”. (Vendimet nr.212, datë 29.10.2002; nr. 29, datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese) Për këtë shkak, është prekur, parimi i shtetit të së drejtës, i shprehur me përparësinë e normave të Kushtetutës në raport me normat e tjera ligjore. (Vendimet nr. 9 datë 01.03.202; nr. 25, datë 05.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese)

117. Rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë. Uniteti i këtij sistemi qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës së “krijuar”. (Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese) Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. (Vendimet nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese) Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, në të kundërt çënohet parimi i kushtetutshmërisë që detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. (Vendimet nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 25, datë 28.04.2014; nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese)

118. Sipas këtij parimi të gjitha organet, e parashikuara ose jo në Kushtetutë, duhet t'i nënshtrohen parimit të kushtetutshmërisë pasi vetëm në këtë mënyrë garantohet shteti i së drejtës. Duke mbajtur parasysh se shteti ka për detyrë respektimin dhe mbrojtjen e bazave (vlerave themelore) të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, Gjykata nënvizon se organet shtetërore në aktet që miratojnë dhe në veprimet që kryejnë, nga njëra anë, duhet të frymëzohen nga këto vlera themelore (neni 3). Në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të

ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*), kjo në funksion të ruajtjes së strukturës së burimeve të së drejtës dhe, bashkë me të, të respektimit të vlerave për mbrojtjen e të cilave ajo është përcaktuar. (*Vendimi nr. 29 datë 02.07.2021 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimet nr.171/2007, nr.128/2008, nr.22/2012 dhe nr.34/2013 të Gjykatës Kushtetuese italiane*)

119. Në rastin konkret, dispozitat kushtetuese (neni 135, neni 148, neni 148/dh) janë të qarta në formulimin e tyre dhe nuk lenë vend për hapësira të tjera ndërhyrjeje dhe nuk bëjnë asnjë lloj autorizimi për ligjvënësin. Kushtetuta ka trajtuar në mënyrë eksplicite dhe shteruese kompetencën e Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave të posaçme në drejtim të rrethit të funksionarëve të lartë, akuzat penale ndaj të cilëve hetohen dhe ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme dhe gjykohen nga gjykatat e posaçme, si dhe përmes dispozitave kushtetuese nuk u autorizua ligjvënësi për të shtuar me ligj rrethin e këtyre funksionarëve, duke përcaktuar në këtë mënyrë kufijtë e të drejtave të këtyre organeve lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e “funksionarëve të lartë”. Si rrjedhojë, ligjvënësi nuk duhet të kishte ndryshuar me ligj këtë kompetencë kushtetuese të Prokurorisë së Posaçme. E kundërta bie ndesh me parimin se uniteti i sistemit normativ qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës “së krijuar”. (*Vendimi nr. 25, datë 05.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese*)

120. Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartës i sovranitetit të popullit shfaqet para së gjithash si organ ligjvënës dhe në ushtrimin e këtij funksioni kryesor, ai mbështetet së pari te dispozitat kushtetuese, sepse ligjet që miraton duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të tyre. Në këtë kuptim, ai shfaqet edhe si interpretues i parë i normës kushtetuese. Hapësira e këtij interpretimi varet nga karakteri dhe natyra e dispozitave kushtetuese që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ligjin që do të miratohet ose me dispozita të veçanta të tij. E rëndësishme është të ruhen, në çdo rast, vlerat dhe parimet themelore të deklarimeve kushtetuese. Brenda kësaj hapësire, Kuvendi ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, të cilat janë përcaktuar si prioritet në programin zgjedhor të shumicës parlamentare. Përveç kësaj, Kuvendi, përmes procesit ligjvënës, ka detyrën dhe përgjegjësinë t’u përgjigjet në mënyrë të vazhdueshme, me realizëm, sa më shpejt dhe sa më drejt edhe prioritetëve apo problemeve të ndryshme të vendit. Në të gjitha rastet, është e rëndësishme të ritheksohet se ligji i ri apo dispozita të veçanta të tij të mos bien ndesh me dispozitat kushtetuese, pasi Kushtetuta qëndron në majë të piramidës së akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë. (*Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese*) Në rastin konkret, Kuvendi ka vepruar në kundërshtim me

parashikimet kushtetuese, duke cënuar edhe parimin e shtetit të së drejtës në komponentin e sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, sepse kemi të bëjmë me një parashikim ligjor që është i papajtueshëm me Kushtetutën.

121. Sa më sipër sjell problematika kushtetuese edhe në drejtim të pavarësisë funksionale të prokurorive të zakonshme, si dhe të drejtës për proces të rregullt gjyqësor, pjesë e të cilit ndër të tjera është parimi i barazisë së palëve dhe e drejta për tu gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Nëpërmjet nenit 14 të ligjit nr. 95/2016 preket pavarësia funksionale e prokurorive të zakonshme, kjo sepse **bazuar në parashikimet kushtetuese në fuqi, kompetencën për hetimin dhe ndjekjen penale të prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm nuk e ka Prokuroria e Posaçme, këtë kompetencë Kushtetuta ja njih prokurorisë së zakonshme.** Paragrafi i parë i nenit 148 të Kushtetutës parashikon se Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese. Në përputhje me detyrat që i ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm që i jep atij mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. *(Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese)*

122. Ndërkohë, pavarësia e gjyqtarëve nuk është qëllim në vetvete, as një mënyrë për të siguruar pozicionin profesional të gjyqtarëve për të mirën e tyre, dhe as një privilegj, por është një mjet për të arritur qëllimet e një shoqërie të drejtë dhe të përparuar dhe një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave. *(Vendimi nr. 149 datë 20.12.2013 i Gjykatës Kushtetuese)* Për këtë arsye, pavarësia shoqërohet me mjete për të siguruar, që gjyqtarët dhe gjyqësori në tërësi, të veprojnë në përputhje me parimet dhe interesat legjitime të një shoqërie demokratike. Pavarësia substanciale, që do të thotë “liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit”. *(Vendimi nr. 46 datë 29.06.2015 i Gjykatës Kushtetuese)*

123. Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së gjyqtarëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në Kushtetutë dhe në

ligje. Në vendimmarrje gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të aftë të veprojnë pa ndikim të papërshtatshëm, presione, kërcënime ose ndërhyrje, të drejtpërdrejta ose jo, nga kushdo dhe për çfarëdo arsye. Gjyqtarët duhet të kenë liri të plotë për t'i vendosur rastet me paanësi, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin e tyre për faktet dhe në zbatim të normave të së drejtës”. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve. Mbi këtë bazë, krijohen raporte të caktuara ndërmjet organeve dhe institucioneve qendrore kushtetuese që përfaqësojnë një nga tre pushtetet kryesore, por duke bërë kujdes që në çdo rast të respektohet pavarësia kushtetuese e secilit prej tyre. (*Vendimi nr. 11, datë 02.04.2008 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese*) Nga ana tjetër, parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë. (*Vendimi nr.16, datë 25.04.2003 i Gjykatës Kushtetuese*)

124. Duke u ndalur specifikisht tek testi objektiv i paanshmërisë, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se ky test kërkon që të ekzaminohet nëse ekzistojnë fakte bindëse të cilat ngjallin dyshim legjitim se ky gjyqtar nuk ka qenë i paanshëm gjatë gjykimit. (*Vendimet nr. 23, date 04.11.2008; nr. 10, date: 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*) Dispozita ligjore objekt shqyrtimi krijon problematika lidhur me pavarësinë dhe paanësinë e vetë gjyqtarëve të posaçëm, sepse ata në çdo moment mund të konsiderohen “nën presionin” e prokurorëve të posaçëm, për sa kohë këta të fundit në çdo moment mund ti hetojnë dhe ndjekin penalisht gjyqtarët e posaçëm, madje potencialisht edhe për shpërdorim detyre, ose korrupsion pasiv për çështje në të cilat vetë Prokuroria e Posaçme është palë. Kjo sepse neni 137 i Kushtetutës, pavarësisht se parashikon se gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, këtë të drejtë nuk e gëzon nëse dyshohet për dhënie qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi. Në këtë situatë, gjyqtarët e posaçëm nuk janë më *suprapartes*, por nën “presionin” e prokurorëve të posaçëm. Paanshmëria e gjyqtarëve (*nemoiudex in causasua*) kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por edhe të shihet që bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe *super partes*. (*Vendimet nr.5, datë 01.03.2018; nr. 6, datë 15.01.2021 të Gjykatës Kushtetuese*)

125. Si rrjedhojë, kjo sjell cënim të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatës si dhe cënim të parimit të barazisë së palëve, për sa kohë gjyqtarët e posaçëm janë në këtë lloj “presioni” vazhdues ndaj njëres prej palëve në proces, pra ndaj Prokurorisë së Posaçme. E drejta për një gjykim të rregullt e të drejtë përfshin parimin e barazisë së mjeteve, që do të thotë, që secila palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta për të paraqitur çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit. *(Vendimi nr. 7, datë 11.03.2008 i Gjykatës Kushtetuese)*

126. Edhe Vendimi nr. 29/2024 të i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk ishte një vendim që konstituoï kompetencën e gjyqtarëve të posaçëm për gjykimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm dhe as kompetencën e prokurorëve të posaçëm për hetimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm, përkundrazi, ky vendim bëri pikërisht të kundërtën: vlerësoi se referuar kuadrin juridik në fuqi **nuk ka asnjë parashikim kushtetues ose ligjor që të përcaktojë kompetencën e gjykatave të posaçme për gjykimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm vetëm për shkak të funksionit të tyre.** Gjykata e Posaçme mund të gjykojë prokurorët dhe gjyqtarët e posaçëm vetëm (1) kur këto subjekte akuzohen për kryerjen e një prej veprave penale të parashikuara në gërmën “a” dhe “b” të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ose (2) në rastin e procedimeve të lidhura (për të mos analizuar që edhe në rastin e këtyre situatave ka plot vend për diskutim lidhur me implikimet kushtetuese që këto parashikime paraqesin lidhur me paanësinë/pavarësinë e gjykatave të posaçme).

127. Me konkretisht, me vendimin nr. 29/2024 Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të RSH është shprehur për moskalimin për shqyrtim në seancë plenare të kërkesës për kontroll incidental të Gjykatës së Posaçme të Apelit lidhur me nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar. Gjykata referuese kërkoi nga GJK konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të këtyre dispozitave për shkak se ato përcaktojnë kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave të posaçme për hetimin dhe gjykimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve të tyre në lidhje me vepra penale që sipas Kushtetutës përfshihen në kompetencën lëndore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Çështja e shtruar përpara Gjykatës referuese kishte të bënte me shqyrtimin prej saj të ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorisë të posaçme për një kallëzim të kryer nga një i pandehur ndaj disa prokurorëve/gjyqtarëve të posaçëm lidhur me veprimet/mosveprimet e tyre në kuadër të procedimit penal në të cilin ky shtetas ishte i pandehur.

128. Në mënyrë të veçantë në këtë vendim, lidhur me nenin 14 të ligjit 95/2016, GJK shprehet se ky nen i kundërshtuar si antikushtetues, nuk përcakton kompetencën lëndore të gjykatës referuese. **Kompetenca lëndore e gjykatave të posaçme është e përcaktuar vetëm në Kushtetutë dhe Kodin e Procedurës Penale dhe si rrjedhojë, neni 14 nuk e pengon Gjykatën e Posaçme të Apelit në shqyrtimin e çështjes përpara saj.** Për më tepër shprehet GJK, që prokuroria e posaçme e ka regjistruar këtë çështje për shkak të lidhjes së procedimeve dhe jo për shkak të funksionit të subjekteve (gjyqtarë/prokurorë të posaçëm) ndaj të cilëve është bërë kallëzimi nga ana e të pandehurit. Si rrjedhojë, ky vendim nuk mund të thuhet se ka rrëzuar këtë pretendim të kërkuarit.

iii. **Cënimi i së drejtës për mbrojtje efektive, prezumimit të pafajësisë dhe dinjitetit njerëzor për shkak të qëndrimit të kërkuarit në një kafaz metalik gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore**

129. **Gjykata e seanc[s] paraprake lejoi qëndrimin në një kafaz metalik të personit nën hetim Erion Veliaj gjatë zhvillimit të seancë gjyqësore.** Vendosija në kafaz gjatë seancave gjyqësore kufizoi ndjeshëm mundësinë e personit nën hetim Erion Veliaj për të komunikuar lehtësisht me avokatët e tij mbrojtës, duke penguar përgatitjen dhe zhvillimin e një mbrojtjeje efektive, e drejtë kjo e cila është garantuar nga Kushtetuta, K.Pr.Penale dhe KEDNJ. Në praktikën e saj GJEDNJ e ka cilësuar vendosjen e personit të akuzuar në kafaz si cënim të së drejtës së tij për të pasur mbrojtje efektive, në shkelje të nenit 6 § 3 (c) të KEDNJ.

130. Konkretisht në çështjet “Ashot Harutyunyan kundër Armenisë” GJEDNJ vlerësoi se vendosja e të pandehurit në një kafaz gjatë procesit dëmtoi mundësinë e tij për të komunikuar me avokatin dhe për të ndjekur zhvillimin e procesit, duke cenuar të drejtën për mbrojtje efektive. Në çështjen “Moisejevs vs Lituani” (nr. 64846/01, 15.06. 2006) aplikanti u mbajt në kafaz gjatë gjithë procesit gjyqësor. GJEDNJ konstatoi se kjo dëmtoi mundësinë e tij për të komunikuar me avokatin, për të ndjekur zhvillimin e procesit dhe për të kontribuar në mënyrë efektive në mbrojtjen e tij. Në çështjen “A.B. vs Ruisë” nr. 1439/06, 14.10 2010, aplikanti qëndroi gjatë seancave në një kafaz të mbyllur, në kushte që nuk lejonin komunikim të lirë me avokatin. GJEDNJ theksoi se kjo masë e izolimit fizik pengonte aftësinë e të pandehurit për të përgatitur dhe zhvilluar mbrojtjen, duke cenuar neni 6 §3(b) dhe (c). Në praktikën e saj GJEDNJ e ka konsideruar cënim të nenit 6 pika 2 të KEDNJ mbajtjen e personit të akuzuar në një kafaz gjatë seancave gjyqësore. Në çështjen “Svinarenko dhe Slyadnev kundër Ruisë” GJEDNJ theksoi se ekspozimi i të pandehurve në një kafaz gjatë seancave gjyqësore mund të krijojë një imazh negativ të tij si person i rrezikshëm si dhe një perceptim të gabuar rreth

fajësisë së tij, duke minuar rëndë parimin e prezumimit të pafajësisë. Në çështjen “Ashot Harutyunyan v. Armenia (nr. 34334/04, 15.06.2010, aplikanti ishte vendosur në një “kafaz hekuri” gjatë gjykimit. GJEDNJ vlerësoi se mbajtja në kafaz e tij sidomos kur nuk kishte rrezik për sigurinë publike, krijoi perceptimin e tij si “kriminel i rrezikshëm” në cënim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

131. Praktika e mbajtjes së të pandehurit në një kafaz gjatë seancave gjyqësore është cilësuar nga GJEDNJ edhe si shkelje e nenit 6, pika 1, që parashikon të drejtën për një proces të rregullt dhe të drejtë, duke theksuar se ky veprim ndikon negativisht në perceptimin e paanshmërisë së gjykatës dhe në aftësinë e të pandehurit për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proces. Konkretisht në çështjen “Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Ruisë” GJEDNJ konstatoi se mbajtja e të pandehurve në kafaze xhami gjatë seancave gjyqësore kufizoi rëndë komunikimin e tyre me avokatët dhe ndikoi negativisht në të drejtën për një proces të drejtë. Referuar praktikës së GJEDNJ-së, mbajtja e të pandehurit në një kafaz metalik gjatë seancave gjyqësore është konsideruar nga GJEDNJ si shkelje të nenit 3 të KEDNJ. Konkretisht në çështjen “Svinarenko dhe Slyadnev vs Ruisë” GJEDNJ theksoi se mbajtja e të pandehurit në një kafaz metalik gjatë gjithë gjykimit përbente trajtim degradues, pasi synon të poshtërojë të pandehurin, duke i shkaktuar atij ndjenja turpi, frike dhe inferioriteti në sallën e gjyqit. GJEDNJ theksoi se në aspektin psikologjik, prezantimi i një personi të ndaluar në kafaz gjatë seancave gjyqësore, edhe kur ai nuk përbën rrezik konkret për sigurinë publike apo pjesëmarrësit në proces, përcjell një imazh fajësie dhe kriminalizimi, duke nxitur potencialisht paragjykimë edhe tek vetë trupi gjykues.

132. Përtej jurisprudencës së GJEDNJ-së, edhe në diskursin më të gjerë juridik evropian është pranuar se mbajtja e të pandehurit në struktura të mbyllura sigurie gjatë seancave gjyqësore bie ndesh me vetë logjikën e një procesi të drejtë. Qëndrimi kritik i niveleve më të larta të gjyqësorit anglez ndaj përdorimit rutinë të “secure docks” ose kafazeve të sigurisë në sallat e gjyqit, si psh. Lord Chief Justice i Anglisë dhe Uellsit mbështeti një raport të organizatës Justice, i cili theksonte se këto mjedise të mbyllura kompromentojnë të drejtën e të akuzuarit për një proces të rregullt, minojnë prezumimin e pafajësisë dhe e bëjnë më të vështirë pjesëmarrjen reale të tij në seancë.⁹ Në të njëjtën linjë, avokatë me përvojë në mbrojtjen penale kanë theksuar se vendosja e të pandehurit në një kafaz e marginalizon atë, e bën absurd dhe praktikisht të vështirë komunikimin e vazhdueshëm me mbrojtësin, si dhe cenon dinjitetin e

⁹ The Guardian, Senior judge calls for abolition of security cages from courtrooms, <https://www.theguardian.com/law/2015/jul/03/senior-judge-abolition-courtroom-docks-security-cage>

personit përballë gjykatës. Po sipas këtij raportimi, rekomandimi ishte që rregulli të ishte ulja e të pandehurit pranë ose pas avokatit të tij, ndërsa **çdo masë shtesë sigurie të vendosej vetëm pas një vlerësimi procedural konkret dhe jo si praktikë automatike**. Kjo qasje është me rëndësi edhe për rastin konkret, sepse tregon se kundërshtimi ndaj mbajtjes së të akuzuarit në kafaz nuk është vetëm çështje perceptimi subjektiv apo retorike mbrojtëse, por një shqetësim serioz i vetë kulturës juridike evropiane mbi standardet minimale të një gjykimi të drejtë.

133. Nuk është rastësi që në mendimin juridik evropian dhe anglo-sakson praktika e mbajtjes së të pandehurit në kafaz ose në “secure dock” është kritikuar si një mbetje anakronike e një drejtësie penale të tejkaluar.¹⁰ Këto struktura të mbyllura nuk përmbushin një funksion neutral organizativ, por prodhojnë pasoja të drejtpërdrejta mbi drejtësinë e procesit: ato e paraqesin të akuzuarin si person të rrezikshëm, dobësojnë prezumimin e pafajësisë, dëmtojnë dinjitetin njerëzor dhe e pengojnë atë të komunikojë lirshëm e në mënyrë të menjëhershme me avokatin e tij. Izolimi fizik i të pandehurit në sallën e gjyqit e vendos atë në pozitë inferiore procedurale ndaj prokurorisë dhe e bën pothuajse absurd ushtrimin praktik të së drejtës së mbrojtjes në kohë reale. Pikërisht për këtë arsye, vendi normal i të pandehurit në një proces penal duhet të jetë pranë mbrojtjes dhe jo në një kafaz, ndërsa çdo masë më kufizuese duhet të mbështetet në një nevojë konkrete dhe të individualizuar sigurie. Kjo analizë përforcon përfundimin se mbajtja e të akuzuarit në kafaz gjatë seancës nuk është thjesht çështje forme, por një zgjedhje që prek në substancë barazinë e armëve, prezumimin e pafajësisë dhe vetë dinjitetin e personit të gjykuar.

134. Edhe në rastin konkret, mbajtja e z. Veliaj përgjatë seancave gjyqësore në kafaz sigurie, shoqëruar kjo me fotografimin e tij mbrapa hekurave në kafaz dhe publikimi në media i këtyre fotografive, është një dëshmi shtesë e mohimit të prezumimit të pafajësisë, për më tepër në rrethana ku personi nën hetim nuk është akuzuar për një vepër të dhunshme, ka karakter të mire, një pozitë të lartë në shoqëri etj. Nxjerrja e parakohshme dhe e paautorizuar e informacionit delikat ka shkaktuar dëme të konsiderueshme reputacionin e z. Veliaj dhe familjes së tij, duke shtuar më tej padrejtësinë e qenësishme të procesit hetimor.

¹⁰ The Times, The dock: a nasty relic of 18th century injustice, <https://www.thetimes.com/uk/crime/article/the-dock-a-nasty-relic-of-18th-century-injustice-57j05cxjr3t>

iv. Lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të paragrafit të parë të nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale

135. Neni 332/gj, paragrafi 1, i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankim, bie ndesh me Kushtetutën jo thjesht për shkak të pasojës që ka prodhuar në rastin konkret, por për vetë përmbajtjen normative të tij. Papajtueshmëria kushtetuese e kësaj dispozite qëndron në faktin se ajo **përrjashton në mënyrë absolute, të përgjithshme dhe pa asnjë filtër proporcionaliteti** kontrollin gjyqësor mbi një vendim që prek drejtpërdrejt pozitën procedurale të të pandehurit dhe që shënon kalimin nga faza e hetimit në fazën e gjykimit në themel. Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake nuk është një akt thjesht teknik i administrimit të dosjes/çështjes, por një vendim që verifikon nëse akuza ka një minimum ligjshmërie, qartësie dhe mbështetjeje provuese për të justifikuar ekspozimin e individit ndaj gjykimit penal publik.

136. Në rendin kushtetues shqiptar, e drejta për proces të rregullt ligjor nuk reduktohet vetëm te gjykimi në themel, por përfshin edhe garancitë procedurale që e paraprijnë atë, sa herë që në këto faza merren vendime të afta të prodhojnë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale mbi të drejtat e individit. Pikërisht për këtë arsye, neni 42 i Kushtetutës, i lexuar së bashku me nenin 43 të saj, **nuk lejon që ligjvënësi të krijojë zona të tëra procedurale të përjashtuara *apriori* nga çdo mjet ankimi**, kur në ato zona vendosen çështje që prekin ligjshmërinë e akuzës, saktësinë e formulimit të faktit penal, identifikimin e burimeve të provës dhe vetë ligjshmërinë e kalimit në gjykim. Kjo dispozitë, duke qenë se ndalon ankimimin në mënyrë kategorike ndaj këtij vendimi, pa dalluar natyrën dhe gravitetin e shkeljes që mund të ketë ndodhur në seancën paraprake, dobëson thelbin e garancisë kushtetuese të mbrojtjes efektive, si dhe të drejtës së ankimit.

137. Neni 43 i Kushtetutës, ka sanksionuar si rregull të përgjithshëm të drejtën e kujtudo për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Vetëm përjashtimisht, Kushtetuta lejon që ligji të parashikojë ndryshe, dhe këtë **vetëm për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël**, gjithmonë në përputhje me kriteret kufizuese të nenit 17 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vetë teksti kushtetues e kufizon në mënyrë të qartë hapësirën e ligjvënësit për të përjashtuar të drejtën e ankimit. Në këtë kuptim, paragrafi i parë i nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale, i cili ndalon në mënyrë absolute ankimin kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq, **del jashtë kufijve që lejon neni 43 i Kushtetutës**. Ky vendim nuk ka të bëjë me një kundërvajtje të lehtë penale, por me një akt gjyqësor që përcakton kalimin e individit në gjykim penal dhe që prek drejtpërdrejt pozitën e tij procedurale, interesat e tij themelore dhe të drejtën e mbrojtjes. Si i

tillë, ai nuk mund të përjashtohet nga e drejta e ankimit me një dispozitë ligjore të zakonshme, pasi Kushtetuta nuk i njeh ligjvënësit një kompetencë të tillë përtej rasteve të kufizuara që ajo vetë ka përcaktuar.

138. Për më tepër, edhe sikur të pranohej se ligjvënësi disponon një hapësirë të caktuar vlerësimi në rregullimin e mjeteve të ankimit, përsëri kufizimi i parashikuar nga neni 332/gj nuk do të mund të qëndronte, sepse ai është absolut, nuk bën asnjë dallim sipas natyrës së shkeljes, nuk parashikon asnjë filtër proporcionaliteti dhe cenon thelbin e së drejtës së ankimit në një fazë vendimtare të procesit penal. Për këtë arsye, ky parashikim bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 43 të Kushtetutës, të lexuar në harmoni me nenin 17 të saj. Antikushtetutshmëria e nenit 332/gj bëhet edhe më e dukshme në raport me funksionin që ka seanca paraprake në procesin penal. Duke qenë se kjo fazë është konceptuar si filtër garantist për të penguar dërgimin në gjyq të akuzave të paqarta, të pambështetura ose proceduralisht me potencialin për të qenë të cenueshme (nisur kjo nga parimi kushtetues i barazisë së palëve), atëherë vendimi që del prej saj nuk mund të jetë njëkohësisht i paeksponuar ndaj çdo lloj forme kontrolli. Përndryshe, faza paraprake humbet funksionin e saj si barrierë ndaj arbitraritetit dhe kthehet në një hallkë formale, ku gjyqtari mund të marrë edhe një vendim me mangësi të rënda pa ekzistuar asnjë mjet i brendshëm korrigjues. Kjo do të thotë se vetë garancia procedurale që ligji pretendon të ndërtojë neutralizohet nga ndalimi i kontrollit mbi rezultatin e saj.

139. Po kështu, dispozita që ndalon ankimin ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake është joproporcionale. Edhe nëse pranohet se ligjvënësi mund të synojë shmangien e zvarritjeve procedurale ose përshpejtimin e kalimit të çështjes në themel, ndalimi absolut i ankimit nuk përmbush kërkesën kushtetuese të proporcionalitetit. Midis interesit për efikasitet procedural dhe së drejtës së individit për t'u mbrojtur nga një dërgim i paligjshëm në gjyq, ligjvënësi ka zgjedhur mjetin më ekstrem të mundshëm: eliminimin total të ankimit. Një zgjidhje e tillë nuk është as e domosdoshme, as e balancuar, sepse i njëjti qëllim mund të realizohej përmes mjeteve më pak kufizuese, si p.sh. një ankim i kufizuar, me afat të shkurtër, vetëm për shkelje të rënda procedurale, për mungesë arsyetimi, për mosrespektim të elementeve të nenit 332/e, etj.

140. Për më tepër, neni 332/gj krijon një pabarazi të pajustificuar brenda së njëjtës fazë procedurale. Vetë Kodi lejon ankim kundër vendimeve të gjyqtarit të seancës paraprake kur vendoset pushimi i akuzës ose i çështjes, ndërsa e ndalon kategorikisht kur vendoset dërgimi në gjyq. Kjo do të thotë se sistemi procedural **i njeh nevojën e kontrollit në apel për vendimet që favorizojnë të pandehurin, por e mohon atë pikërisht për vendimin që e rëndon pozitën e tij dhe që e ekspozon ndaj procesit penal në themel.** Kjo asimetri nuk mbështetet mbi ndonjë kriter objektiv e racional; përkundrazi, ajo përmbys logjikën e garancive procedurale

dhe cenon barazinë e armëve, sepse shteti ruan mundësinë e kontrollit kur preket interesi ndëshkues, ndërsa individit ia mohon atë kur preket interesi i tij themelor për të mos u gjykuar pa bazë të ligjshme.

141. Në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, në mungesë të çdo mjeti ankimi, vlerësimi i gjyqtarit mbi mjaftueshmërinë e provave, qartësinë e akuzës, respektimin e kufijve të kërkesës së prokurorit dhe ligjshmërinë e kalimit të çështjes në gjyq mbetet praktikisht i pakontrollueshëm. Kjo do të thotë se ligji i njuh një organi gjyqësor fuqinë për të marrë një vendim me pasoja të drejtpërdrejta dhe të rënda për pozitën procedurale të të pandehurit, pa parashikuar asnjë mekanizëm të brendshëm korrigjues ndaj gabimit, arbitraritetit ose mungesës së arsytimit. Në një shtet të së drejtës, asnjë pushtet procedural që prek liritë dhe të drejtat themelore të individit nuk mund të jetë absolutisht i imunizuar nga kontrolli. Ndalimi absolut i ankimit ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprahe sjell si pasojë eliminimin e çdo mekanizmi kontrolli **mbi cilësinë e arsytimit të këtij vendimi**.

142. Në një sistem kushtetues që garanton procesin e rregullt ligjor, arsytimi i vendimeve gjyqësore nuk është një element formal, por një garanci thelbësore kundër arbitraritetit. Pikërisht për këtë arsye, kontrolli në një instancë më të lartë shërben si instrument për të verifikuar nëse gjykata ka analizuar në mënyrë reale ekzistencën e provave të mjaftueshme, ligjshmërinë e akuzës dhe respektimin e standardeve procedurale. Duke përjashtuar çdo mundësi ankimi, neni 332/gj krijon një situatë ku edhe një vendim i paarsyetuar, i pamjaftueshëm në analizë apo i mbështetur në vlerësime sipërfaqësore mbetet i pakorrigjueshëm. Në këtë mënyrë, dispozita jo vetëm që kufizon një mjet procedural, por **cenon drejtpërdrejt thelbin e parimit të arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe krijon rrezik real për vendimmarrje arbitrare**, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe standardet e një procesi të rregullt ligjor. Përjashtimi i çdo forme ankimi ndaj vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq i jep gjyqtarit të seancës paraprahe një **pushtet vendimmarrës të pakontrolluar**, i cili nuk i nënshtrohet asnjë verifikimi nga një instancë më e lartë gjyqësore. Në këto kushte, vlerësimi mbi ekzistencën e provave të mjaftueshme, mbi qartësinë dhe ligjshmërinë e akuzës, si dhe mbi respektimin e garancive procedurale mbetet ekskluzivisht në diskrecionin e një gjyqtari të vetëm, pa asnjë mekanizëm korrigjues.

143. Pra, në planin kushtetues, neni 332/gj nuk kufizon vetëm një mjet procedural; por përjashton vetë mundësinë e korrigjimit të një shkeljeje që ndodh në një moment vendimtar të procesit penal. Nëse vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq merret në kundërshtim me kërkesat e ligjit, dëmi kushtetues fillon që në momentin kur individi detyrohet të përballet me një gjykim që nuk duhej të hapej në atë formë ose në ato kushte, pra nuk qëndron vetëm te

rezultati final i procesit. Pikërisht sepse ky dëm është i menjëhershëm dhe në një masë të caktuar i **pariparueshëm ex post**, mungesa e ankimit e bën cenimin kushtetues autonom dhe aktual.

144. Për këto arsye, paragrafi i parë i nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale duhet të konstatohet si i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi cenon thelbin e së drejtës për mbrojtje gjyqësore efektive, si dhe të drejtën e ankimit, zbraz nga përmbajtja kontrollin ndaj një vendimi me pasoja të drejtpërdrejta për të pandehurin, krijon një regjim procedural asimetrik e të pajustificuar në disavantazh të të pandehurit, si dhe vendos një kufizim joproporcional mbi të drejtën për proces të rregullt ligjor.

Për sa më sipër, përfundimisht,

KËRKOJMË

- 1) Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.29, datë 9.02.2026 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (vendim i gjyqtarit te seancës paraprake znj. Etleva Deda).
- 2) Pavlefshmërinë e të gjitha seancave të zhvilluara në lidhje me procedimin penal nr. 27/2024 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar pas datës së dhënies së vendimit nr.29, datë 9.02.2026 të gjyqtarit të seancës paraprake znj. Etleva Deda.
- 3) Konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të paragrafit të parë të nenit 332/gj të Kodit të Procedurës Penale.
- 4) Konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr. 95, datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
- 5) Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

KËRKUESI

Erion VELIAJ

Av. Plarent NDRECA